

rr. Migjeni nr.1, 10000 Prishtinë
Tel: 038 244 396; Fax: 038 243 828
e-mail: bek@bekonomike.com
www.bekonomike.com

Prishtinë

rr. Luan Haradinaj p.n.
Tel. 038 229 497
Fax. 038 243 828

Mitrovicë,

Rr. Agim Hajrizi nr.26,
Tel.&Fax.: 028/34 700

Pejë

rr. "122" nr.2
Tel.&Fax.: 039/348 15

Gjakovë

rr. UÇK-së, p.n.
Tel.&Fax.: 0390/24 861

Prizren

sheshi "Skenderbeu" p.n.
Tel.&Fax.: 029/42 234

Ferizaj

rr. Bislim Rexhepi p.n.
Tel.&Fax.: 0290/21 260

Gjilan

rr. Adem Jashari p.n.
Tel.&Fax.: 0280/23 609

Ekspozitura në Burim (Istog)

rruga kryesore p.n.
Tel.&Fax.: 039/51 339

Ekspozitura në Rahovec

rr. "Sylejman Vokshi" nr.2
Tel.: 029/ 77 902

S H Ě R B I M I Y N Ě I R I



B A N K O M A T I

2 4 h T Ě R H E Q J E T Ě H O L L A S H

Banka Ekonomike edhe me një shërbim të ri për ju!

Në të gjitha filialat tona, kemi vendosur edhe ATM aparatet - Bankomatët, ku ju mund të bëni tërheqje të hollash gjatë 24 orëve, çdo ditë të javës. Për të pasur mundësinë e tërheqjes së të hollave ju duhet të keni kartelën BEXCard, të cilën do të mund ta merrni në të gjitha filialat e Bankës Ekonomike në Kosovë. Aplikoni menjëherë dhe shfrytëzoni mundësitë që ua ofrojmë ne!

 **Banka
Ekonomike**

PËRMBAJTJA

- 03-04 Fjala përshëndetje e Drejtorit Gjeneral
- 05-08 Vështrim i përgjithshëm i ekonomisë Kosovare
 - > Produkti i Brendshëm Bruto (GDP)
 - > Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore
 - > Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet
 - > Inflacioni
 - > Tregtia e jashtme
 - > Papunësimi
 - > Sistemi bankar dhe finanacat
- 09-15 Vështrimi mbi afarizmin e Bankës Ekonomike gjatë vitit 2005
 - > Numri i llogarive të klientëve
 - > Depozitat
 - > Kreditimi
 - > Qarkullimi i pagesave
 - > Të ardhurat dhe shpenzimet
 - > Zgjerimi dhe modernizimi
- 16 Këshilli Drejtues. Drejtuesit
- 17 Bankat korrespondente
- 18 Raporti i auditorëve të pavarur
- 19-45 Pasqyrat financiare

Ne avansojmë biznesin tuaj

Kush jemi Ne

Vizioni ynë është që të bëhemi bankë udhëheqëse në plotësimin e nevojave të klientëve.

Për të arritur atë, ne kemi krijuar politikat për të gjithë palët që përbëjnë aktivitetin tonë:

Për klientët - t'ju ndihmojmë atyre që të realizojnë atë që kanë planifikuar

Për të punësuarit - të krijojmë një ambient ku të gjithë do të tregojnë kualitetet e tyre punuese.

Për shoqërinë - të krijojmë një ndryshim të vërtetë pozitiv

Për aksionarët - të gjenerojmë dobi më të lartë nga investimet e tyre, sesa mesatarja e dobive në bankat e tjera.

“Ne besojmë se një kompani e suksesshme gjeneron dobi të vazhdueshme për aksionarët si dhe krijon ndryshime pozitive në shoqëri”



Hajrullah Zaiti,
Drejtor Gjeneral

Zonja dhe Zotërinj të nderuar,

Banka Ekonomike, sh.a.Prishtinë, Kosovë, në këtë vit shënon 15 vjetorin e themelimit dhe 5 vjetorin e rilicënsimit nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës "BPK". Banka në tërë këtë periudhë ka punuar me sukses, duke e fituar reputacionin dhe imazhin e bankës së suksesshme e të besueshme.

Duhet theksuar se Banka pas lufte të gjithë kursimtarëve dhe depozitarëve të vet i'u ka kthyer në tërësi kursimet dhe depozitat e tyre.

Banka Ekonomike në vazhdimësi punoi me sukses duke rritur kapitalin, depozitat, nivelin e kredive, zgjerimin e bazës materiale, numrin e klientëve, hapjen e degëve, nëndegëve dhe zyrave të reja në tërë Kosovën.

Banka vazhdimisht u përkujdes për zgjerimin e produkteve të reja bankare, përmirësimin e shërbimeve, kushteve të kredive, etj, dhe është në hap me bankat e tjera në Kosovë. Në fund të vitit 2005 Banka afarizmin e vetë e kryen në 25 njesi. Me Bankën tonë punojnë firmat më të suksesshme, të cilat bashkëpunojnë me partnerët e vetë në tërë botën. Këto firma një pjesë të konsiderueshme të afarizmit e kryejnë përmes Bankës sonë.

Viti 2005, për afarizëm në përgjithësi dhe për atë bankar, në veçanti ka qenë më i dobët se viti para tij. Trende të ngjashme e përcjellin afarizmin edhe në tre mujorin e parë të këtij viti me tendencë të përkeqësimit. Fondet nga jashtë janë zvogëluar tej mase. Gjer në fund të vitit nuk parashihen mjete të reja. Edhe mjetet e fondeve të ndryshme si ai i privatizimit, fondi pensional etj, si burime të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të një vendi, janë jashtë funksionit.

Më lejoni të apostrofoi edhe të arritura të Bankës. Shuma e aktivës

Banka në tërë këtë periudhë ka punuar me sukses, duke e fituar reputacionin dhe imazhin e bankës së suksesshme e të besueshme.

* * *

Banka Ekonomike në vazhdimësi punoi me sukses duke rritur kapitalin, depozitat, nivelin e kredive, zgjerimin e bazës materiale, numrin e klientëve, hapjen e degëve, nëndegëve dhe zyrave të reja në tërë Kosovën.

Shuma e aktivës ishte mbi 45,3 mil. €, numri i klientëve arrin në 34.105; gjatë vitit 2005 numri i klientëve është shtuar për 5396.

* * *

Depozitat në fund të vitit ishin 38,7 mil. € dhe janë rritur për 24%.

* * *

Parimi kryesor i Menaxhmentit të Bankës dhe organeve drejtuese ka qenë të zbatohet ligji dhe rregullat e BPK-së dhe me këtë është krijuar siguri e plotë për kursimtarët, depozituesit dhe Bankën në përgjithësi.

ishte mbi 45,3 mil €, numri i klientëve arrin në 34.105; gjatë vitit 2005 numri i klientëve është shtuar për 5396. Depozitat në fund të vitit ishin 38,7 mil € dhe janë rritur për 24%. Depozita të afatizuara janë 71,4%. Kreditë kanë shënuar rritje për 24,3%.

Banka gjithsejt ka lejuar kredi në shumën prej 108,6 mil € e në shfrytëzim 20,971 mil.

Qarkullimi i pagesave, brënda dhe jashtë vëndit, është realizuar në shumën 244 mil. €.

Të ardhurat janë realizuar mbi 4,6 mil €. Rritja e shpenzimeve ka qënë më e ngadalshme se e të hyrave, 4.2 mil €, pra banka punoi me fitim.

Fitimi i realizuar është 460.353 €.

Këto rezultate janë arritur falë angazhimeve të përbashkëta të Këshillit Drejtues, Menaxhmentit dhe personelit të Bankës.

Duke marrë parasysh vështirësitë ekonomike në rritje, e si rrjedhim edhe rreziqet potenciale që ato paraqesin për afarizmin bankar, janë ndërmarrë masa të vazhdueshme për ruajtjen e stabilitetit të Bankës krahas zhvillimit, zgjerimit, plotësimit dhe shtimit të spektrit të produkteve bankare si dhe përgatitjes e aftësimin të vazhdueshëm të kuadrit e stafit të Bankës. Në kushtet dhe rrethanat që u përmendën, mund të konsiderohen se viti 2005 ishte vit i suksesshëm për Bankën.

Me angazhime të vazhdueshme e të shtuara, presim edhe rezultate më të mira në vitin në vijim. Auditimin e ka kryer firma KPMG.

Parimi kryesor i Menaxhmentit të Bankës dhe organeve drejtuese ka qënë të zbatohet ligji dhe rregullat e BPK-së dhe me këtë është krijuar siguri e plotë për kursimtarët, depozituesit dhe Bankën në përgjithësi.

Banka gjithnjë ka siguruar likuiditet të lartë dhe për këtë arsye është afirmuar dhe njihet si Bankë stabile në tregun bankar.

Një vlerësim i tillë e konfirmon rrugën e drejtë që ka ndjekë Banka dhe organet e saj.

Në Raportin e Punës së Bankës, në vitin 2005, janë dhënë shënime dhe detale për tregun financiar në Kosovë, për ecuritë ekonomike-shoqërore, etj. Për këtë edhe ne si Bankë nuk kemi mundur më saktësisht të parashikojmë më afër prespektivën e zhvillimit ekonomik, por duke marrë parasysh resurset njerëzore, pasuritë natyrore, përkrahjen e pritur financiare pas zgjidhjes së statusit, i cili u stërzgatë, mund të presim rimëkëmbje të ekonomisë në periudhën e ardhëshme pesëvjeçare.

Në këtë aspekt e shohim edhe ne zhvillimin e sistemit bankar dhe prespektivën tonë.

Me respekt

Hajrullah Zaiti

Drejtor i përgjithshëm

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË KOSOVARE

Gjatë luftës në vitin 1999 ekonomia kosovare tërësisht u shkatërua. Menjëherë pas luftës filloi rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i vendit me ndihmën financiare të bashkësisë ndërkombëtare. Progresi më i madh është arritur në zhvillimin e sektorit privat të ekonomisë dhe krijimit të sistemit bankar me 7 banka komerciale të nivelit të dytë, të licensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës. Niveli i arritur i zhvillimit ekonomik deri në fund të vitit 2005 në bazë të Produktit të brendshëm bruto (GDP) ishte i ulët, përkatësisht nën nivelin e vitit 1989 dhe nuk ishte i mjaftueshëm për zbutjen e papunësisë, rritjen e standartit të punëtorëve dhe zgjidhjen e problemit të pensionerëve.

Në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomiko-social të Kosovës kanë ndikuar më së shumti: trashigimi i ekonomisë së shkatëruar si rrjedhim i manaxhimit të keq që nga viti 1989 dhe djegieve e plaçkitjeve që iu bënë gjatë luftës, mospërfundimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, mosinteresimi i investitorëve të huaj për investime në ekonominë kosovare dhe ndërlikohjes së saj me tregun e jashtëm për shkak të moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Edhe në vitin 2005 vazhdoi realizimi i bruto prodhimit shoqëror për kokë banori ndër më të ulët në rajon, ndërsa përqindja e papunësisë ishte më e larta (60%) me tendencë të keqësimit. Mbulesa e importit të mallrave dhe shërbimeve me eksporte në fund të vitit 2005 ishte e ulët, si në vitin e kaluar (4,0%) për shkak të varësisë së ekonomisë kosovare nga importet, që tregon zhvillimin e ulët global dhe strukturuar të ekonomisë.

Buxheti i Kosovës i formuar nga të hyrat vetanake (kryesisht nga dogana dhe taksat) në fund të nëntorit të vitit 2005 shënoi sufiçit prej 15.9 milion euro, në krahasim me defiçitin e realizuar në fund të vitit paraprak prej 134.3 euro. Sufiçiti i realizuar ishte më tepër rezultat i nivelit të ulët të pagave dhe mosrritjes së tyre në sek-

torin e arsimit, shëndetësisë dhe administratës buxhetore.

Niveli i ulët i pagave të punëtorëve në sektorin publik që finansohet nga buxheti, sektorin privat, pensionet e ulëta dhe mosaktivizimi i ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara, krahas investimeve të vogëla në industri e bujqësi, ndikuan në rënien e vazhdueshme të aftësisë blerëse të popullsisë dhe qarkullimit të mallrave e të shërbimeve, duke vështirësuar afarizmin e bizneseve dhe varësinë e tyre prej kredive të bankave komerciale dhe mikroinstitucioneve financiare në Kosovë.

1.1. Produkti i brendshëm bruto (GDP)

Produkti i brendshëm bruto (GDP) për kokë banori gjatë periudhës 2001-2005, ishte më i larti në vitin 2001 (1.306 euro), ndërsa në fund të vitit 2005 është realizuar në shumën 1.227 euro, ose për 6.1% më pak.

Niveli i ulët i Produktit të brendshëm bruto për kokë banori është rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës pas luftës dhe në krahasim me vëndet e rajonit është vëndi më i pazhvilluar .

Realizimi i Produktit të brendshëm bruto në Kosovë në nivel kaq të ulët është rrjedhim i disa faktorëve: mungesës së prodhimit vendor, investimeve të huaja, ngadalësimit të procesit të privatizimit e mosaktivizimit të ndërmarrjeve të privatizuara, rënies drastike të donacioneve të bashkësisë ndërkombëtare dhe moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Në formimin e Produktit të brendshëm më së shumti kanë ndikuar tre faktorë: asistenca e huaj, dërgimi i mjeteve dhe importet:

Produkti i brendshëm bruto¹⁾

Përshkrimi/Periudha	2001	2002	2003	2004	2005
GDP(në mil.euro)	2.439	2.447	2.42	2.505	2.453
GDP për banorë (në euro)	1.306	1.288	1.252	1.274	1.227
Dërgesat e punëtorëve(në mil euro)	317	341	341	341	345
Ndihma nga jashtë(në mil euro)	1.159	887	688	568	519
Kontributi i drejt-i ndihmës(në mil euro)	589	484	393	330	320
Popullsia(në 000)	1.868	1.9	1.932	1.965	1.999

1) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: " Monthly Statistics Bulletin" dhjetor/05, nr-52, f.15.

1.2 Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore

Me qëllim të administrimit, rikonstruimit të ndërmarrjeve publike dhe privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është themeluar në vitin 2002 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe procesi i privatizimit ka filluar më 15 maj 2003.

Proçesi i privatizimit deri më 31 dhjetor 2004 ishte i ngadalsuar me ndërprerje të përkohëshme dhe rezultoi me privatizimin e 40 ndërmarrjeve shoqërore në shumën e paguar prej 42.4 mil.euro. Numri i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore do të rritet deri në fund të vitit 2005 në 158. Prej tyre, 8 ndërmarrje do të privatizohen me "spin-off" special.²⁾ Të hyrat e përgjithshme nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore do të arrijnë në 176.2 mil.euro. Nga shuma e paguar e mjeteve, punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara do t'i shpërndahej 20%.

1.3 Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore në fund të nëntorit të vitit 2005 janë realizuar në shumë 588.7 mil.euro dhe janë më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak për 11 mil.euro ose për 1.9%.

Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, që nga viti 2003 janë realizuar kryesisht nga të hyrat vendore: dogana, TVSH, tatimi i paragjykuar, tatimi në fitim dhe taksat e tjera. Niveli i të ardhurave të përgjithshme varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit.

Në strukturën e të ardhurave buxhetore, të ardhurat nga dogana të cilat grumbullohen në kufi për shkak të importit të lartë marrin pjesë më 67.9% në fund të nëntorit të vitit 2005 dhe janë më të larta se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak vetëm për 3.6 mil.euro.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore në fund të nëntorit të vitit 2005 janë realizuar në shumën 572.8 mil.euro, përkatësisht më pak se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak për 39.1 mil. euro. Rritja më e ulët shpenzimeve të përgjithshme buxhetore se të ardhurat e përgjithshme buxhetore ka rezultuar me sufiçitin e buxhetit në fund të nëntorit 2005 në shumën 15.9 mil.euro.

Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet³⁾

në mil. Euro

Përshkrimi/ periudha	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Të ardhurat e përgjithshme buxhetore nga taksat	121.7	249.7	444.4	536.4	550.2	514.2
- dogana	115.2	208.7	364.5	428.3	436.1	399.6
- taksat tjera	6.5	41	79.9	108.1	114.1	114.6
Të ardhura të tjera	166.9	122.3	91.3	93.9	85	74.5
Gjithsej:	288.6	372	535.7	630.3	635.2	588.7
Shpenzimet e përgjithshme	234.9	274.8	428.6	567.7	769.5	572.8
Suficiti/ deficieti	53.7	97.2	107.1	62.6	-134.3	15.9

1.4 Inflacioni

Çmimet me pakicë në fund të vitit 2005 kanë shënuar rritje për 2.6% në krahasim me vitin paraprak, kur është shënuar ulëje e tyre për 3.4%.⁴⁾ Rritja e inflacionit ishte më tepër rezultat i inflacionit të importuar, për shkak të importit shumë të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

1.5 Tregtia e jashtme

Gjatë vitit 2005 janë shënuar aktivitete më të mëdha në import se në eksport të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.⁵⁾

Shuma e përgjithshme e importit 1,184.1 mil.euro ishte më e larta pas lufte në Kosovë, ndërsa në krahasim me vitin e kaluar, ishte më e lartë për 11.4%.

Shuma e përgjithshme e eksportit prej 47.5 mil.euro ishte më e ulët se në vitin paraprak për 9 mil.euro, ose për 16%.

Mbulesa e importit me eksport në fund të vitit 2005 ishte shumë e ulët, përkatësisht 4%.

Partnerët kryesor tregtar të importit në fund të vitit 2005 me 74.2% pjesëmarrje janë:

Unioni European	34.5%
Maqedonia	18.5%
Serbia dhe Mali i Zi	14.1%
Turqia	7.1%

Partnerët kryesor tregtar të eksportit me 76.5% pjesëmarrje janë:

Unioni European	37.9%
Maqedonia	20.8%
Shqipëria	10.9%
Bosna e Hercegovina	6.9%

2) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin" dhjetor/05, nr-52, f.13.

3) Burim i njejtë, f.48. 4) Burim i njejtë, f.49. 5) Burim i njejtë, f.51.

1.6 Papunësimi

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës ka rezultuar me rritjen e vazhdueshme të papunësisë që nga viti 2000 dhe në fund të vitit 2005 ka arritur në 319.72⁶⁾:

Periudha	Numri i të papunëve	Femra %	Edukimi elementar %	Edukimi sekondar %	Edukimi universitar %
2000	208.074	43.2	58.1	38.8	3.1
2001	237.958	44.1	60.4	37	2.6
2002	257.505	44.5	61.5	36.2	2.2
2003	282.305	45.4	63	35.3	1.7
2004	301.982	45.7	63.4	35.1	1.5
2005	319.721	46.3	63.5	35	1.5

Pjesëmarrja e femrave në numrin e përgjithshëm të papunësuarve është në rritje dhe në fund të vitit 2005 ka arritur në 46.3%. Ndërsa, sipas kualifikimit shkollor, pjesëmarrje më të lartë ka shënuar edukimi elementar me 63.5%, kurse më të ulët edukimi universitar me 1.5% në fund të vitit 2005.

Të punësuarit janë kryesisht në tregti dhe në sektorin publik me mesatare të ulët të pagave në shumën 150-180 euro, ndërsa me pjesëmarrje në popullsinë aktive deri në 45%, që është më ulta në rajon.

1.7 Sistemi bankar dhe financat

Sistemi bankar i Kosovës përbëhet prej 7 bankave komerciale të nivelit të dytë me 49 degë dhe 174 nëndegë⁷⁾ në tërë teritorin e Kosovës. Selia e të gjitha bankave komerciale është në Prishtinë, ndërkaq degët e tyre janë të hapura në 7 qendrat kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan e Ferizaj.

Bankat me nëndegët e tyre janë të licensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbështetje të Rregullores për linçesimin. Mbikqyrjen dhe Rregullimin e Bankave të vitit 1999. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës vazhdon të jetë e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut, deri në zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe nuk i ka të gjitha autorizimet e një banke qendrore.

Depozitat dhe kreditë e bankave komerciale në

Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme prej viti në vit që nga fillimi i themelimit të tyre në vitin 2000⁸⁾:

në 000 Euro

Përshkrimi/periudha	2000	2001	2002	2003	2004	2005
Depozitat	93.003	492.255	427.194	514.045	692.296	838.584
Kredi	3.148	25.916	86.498	232.773	373.668	492.079
Fitimi neto	3.852	6.716	2.716	6.801	10.349	13.229

Gjatë periudhës gjashtëvjeçare të ekzistimit të bankave të reja komerciale në Kosovë, depozitat kanë shënuar rënie vetëm në vitin 2002 për 13.2% në krahasim me vitin 2001, për shkak të konvertimit të DM në valutën e re EUR në fund të vitit 2001 dhe tërheqjes së një pjese të depozitave gjatë vitit 2002.

Mirëpo, gjatë vitit 2000, 2004 e 2005 u rrit besimi i klientëve (kursimtarëve) në bankat komerciale, si rezultat i likuiditetit të lartë dhe të qëndrueshëm banker dhe depozitat u rritën në fund të vitit 2005 në 838.584.000 euro, përkatësisht për 21.1% në krahasim me vitin 2004.

Depozitat me afat në fund të vitit 2005 shënuan rritje në krahasim me vitin paraprak, duke ndikuar në krijimin e kushteve për një politikë më të qëndrueshme kreditore:

në mil. Euro

Depozitat	2004	2005
Llogari rrjedhëse	278.7	291.1
Depozitat me afat	413.5	547.4
Gjithsej:	692.2	838.5

Me qëllim të ngritjes së nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, bankat komerciale që nga viti 2003 e rritën përkrahjen financiare të aktiviteteve ekonomike nëpërmes të kreditimit. Kreditë e ndryshme të bankave komerciale në Kosovë, për persona juridikë dhe individual u rritën në fund të vitit 2005 për 31.7% në krahasim me vitin paraprak dhe merrnin pjesë më 58.7% në shumën e përgjithshme të depozitave. Nëse krijohen kushtet për aplikimin e tërësishëm të Rregullores mbi hipotekën dhe pengun, bankat do të minimizojnë rrezikun nga kthimi në kohë i kredive dhe do të rrisin pjesëmarrjen e kredive në

6) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: "Monthly Statistics Bulletin" dhjetor/05, nr52, f.49.

7) Burimi i njëjtë, f.39.

8) Shënimet e publikuara të bankave komerciale në gazetën e përditshme.

shumën e përgjithshme të depozitave deri në 70%.

Mirëpo, keqësimi i gjëndjes së përgjithshme ekonomike në vend ndikoi në rënien e aktiviteteve të bizneseve dhe një përkeqësim i tillë ndikoi në kthimin me kohë të kredive, gjë që mund të ndikoj në likuiditetin e bankave dhe zvogëlimin e fitimit apo edhe të humbjeve në banka.

Kreditë në vitin 2005, më së shumti, u shfrytëzuan për biznese të ndryshme nga personat juridik, me këtë strukturë brenda ekonomisë:

tregti	375.882.000 euro ose	76.4%
industri	70.565.000 euro ose	14.3%
bujqësi	11.890.000 euro ose	2.4%
të tjera	33.742.000 euro ose	6.9%
Gjithsej:	492.079.000 euro	100%

Në kuadër të ekonomisë, bujqësia shfrytëzoi më së paku kredi edhe pse ka resurse për një zhvillim shumë më të lartë. Në zhvillimin më të lartë të bujqësisë mund të ndikohet me ndërmarrjen e masave stimulative: politika fiskale, kredi me afat më të gjatë të shfrytëzimit dhe normë më të ulët të interesit, politika doganore, etj. Ndërkaq, shfrytëzimi i ulët i kredive në industri rezultoi me mosinteresimin e investitorëve të huaj për shkak të mosgjydhjes së statusit të Kosovës, përkatësisht garantimit të investimeve.

Struktura e pavolitshme afatore e depozitave, kryesisht deri në 1 vit, ndikoi në shfrytëzimin e kredive, më së shumti deri në 1 vit. Ka pasur shfrytëzim të kredive me afat edhe mbi 12 muaj deri në 36 dhe 60 muaj.

Rritja e afarizmit të bankave komerciale me lansimin e produkteve të reja rezultoi me rritjen e fitimit neto prej vitit në vit përveç në vitin 2002 që ishte më i vogël se në vitet e tjera, për shkak se një bankë realizoi humbje.

Moskrijimi i kushteve për zbatimin në tërësi të Rregullores mbi hipotekën dhe mosefikasiteti i sistemit gjyqësor, edhe në vitin 2005, ndikoi në pasigurinë e bankave për orientimin më të lartë të mjeteve të lira në kreditimin e ekonomisë dhe të populates. Mjetet e lira përkohësisht janë plasuar në bankat korrespondente me normë të ulët të

interesit.

Kapitali financiar i pashfrytëzuar në fund të vitit 2005⁹⁾, ishte:

	<i>në mil.euro</i>
llogaritë rrjedhëse	587.0
depozitat në banka korrespondente	251.5
trusti i pensioneve	143.7
fondi i AKM-së	176.2
Gjithsej:	1.158.4
kredi bankare	492.1
Gjithsej:	666.3

Gjatë vitit 2005 mjetet e lira të Trustit pensional dhe fondit të AKM-së vazhduan të jenë jashtë sektorit bankar në Kosovë.

9) Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës: " Manthly Statistics Bulletin" dhjetor/05, nr.52.


3. VËSHTRIMI MBI AFARIZMIN E BANKËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2005

Banka Ekonomike në fund të vitit 2005 realizoi shumën e aktives prej 45.3 mil.euro dhe shumën e përgjithshme të bilancit prej 47.1 mil euro, duke përfshirë zërat jashtëbilancor. Në krahasim me vitin e kaluar, shuma e përgjithshme e aktives ishte më e lartë për 21.5% dhe shuma e bilancit për 22.7%

Fitimi i përgjithshëm neto për vitin 2005 ishte 368.282 euro dhe në krahasim me vitin e kaluar ishte më i ulët për 53.6%, kryesisht për shkak të rritjes së shumës së rezervave të riskut për kreditë në shfrytëzim.

Norma e dividendës, duke vënë fitimin neto në raport me kapitalin aksionar në fund të vitit 2005, në shumën 4.725.031 euro, ishte 7.8%.

Ecuritë e realizuara afariste të Bankës Ekonomike në fund të vitit 2005 (numri i llogarive të klientëve, depozitat dhe kreditë) ishin në suazat e atyre të planifikuara




3.1 Numri i llogarive të klientëve

Numri i llogarive të klientëve të Bankës Ekonomike ka shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, që nga liçensimi në vitin 2001. Në fund të vitit 2005 është rritur në 34.105 me këtë strukturë:

Përshkrimi / viti	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%	2005	%
Persona juridik	167	12.9	1.042	7.6	166	8.6	2.466	8.9	3.085	9.1
Persona individual	1.129	87.1	12.702	92.4	17.589	91.4	25.743	91.1	31.02	98.9
Gjithsej:	1.296	100	13.744	100	19.249	100	27.809	100	34.105	100

Numri i përgjithshëm i llogarive të klientëve në fund të vitit 2005 ka shënuar rritje për 22.6%, në krahasim me vitin e kaluar.



Llogaritë e klientëve të hapura në Bankën Ekonomike u përkasin personave juridikë dhe individual, vendas dhe të huaj. Llogaritë e personave individual marrin pjesë me 98.9% në numrin e përgjithshëm të llogarive në fund të vitit 2005.

Në kuadër të llogarive të personave individual, shumica e llogarive u përkasin llogarive për pagesën e pagave dhe të pesioneve (26.076 në fund të vitit 2005).

Llogaritë bankare të klientëve sipas strukturës së degëve të Bankës, më së shumti u hapën në degën: Prishtinë (8.298), Pejë (7.860), Gjakovë (6.914), Prizren (4.575) dhe në Mitrovicë (3.736). Në dy degët e tjera janë të hapura 2.770 llogari, përkatësisht në degën në Ferizaj 1.113 dhe në Gjilan 1.657.

3.2 Depozitat

Banka Ekonomike në fund të vitit 2005 realizoi shumën e përgjithshme të depozitave prej 38.7 mil. euro ose për 24.1% më shumë se në vitin e kaluar, me këtë strukturë:

në 000 euro

Përshkrimi/viti	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%	2005	%
Depozitat me afat	2.6	28.8	5.934	45.5	12.778	59.3	21.414	68.5	27.695	71.4
Depozitat pa afat	6.447	71.2	7.119	54.5	8.783	40.7	9.865	31.5	11.066	28.6
Gjithsej:	9.047	100	13.053	100	21.561	100	31.279	100	38.761	100


Depozitat me afat në fund të vitit 2005 kanë shtuar pjesëmarrjen në shumën e përgjithshme të depozitave në 71.4%, që tregon tendencën e kthimit të besimit të kursimtarëve në Bankë dhe krijimin e kushteve për një politikë stabile kreditore.

Rritja e depozitave ndikoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shumën e përgjithshme të depozitave në nivel të bankave komerciale në Kosovë: nga 4.1% në vitin 2003, në 4.5% në vitin 2004 dhe në 4.6% në vitin 2005.

VËSHTRIMI MBI AFARIZMIN E BANKËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2005

Me Planin e biznesit për vitin 2006 është parashikuar rritja e pjesëmarrjes në depozitat e bankave në 6.9%.

Shuma e përgjithshme e depozitave në fund të vitit 2005 ka patur këtë përbërje:




3.3 Kreditimi

Shuma e përgjithshme e kredive në shfrytëzim është rritur prej 16.869 mijë euro në fund të vitit 2004, në 20.971 mijë euro në fund të vitit 2005, përkatësisht për 24.3%

Që nga qeshori i vitit 2001, me fillimin e punës së Bankës, e deri në fund të vitit 2005 janë lejuar 6.516 kredi në shumën prej 108.575.554 euro, ndërsa janë në shfrytëzim 2.271 kredi në shumën prej 20.971.044 euro, me këtë strukturë:

Të lejuara						Në shfrytëzim më 31.12.2005					
Ndërmarrje		Pers. Indiv.		Gjithsej		Ndërmarrje		Pers. Indiv.		Gjithsej	
Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
2.427	101.665	4.089	6.911	6.516	108.576	446	18.347	1.825	2.624	2.271	20.971


Kreditë kanë shënuar rritje të vazhdueshme prej vitit në vit, duke u rritur prej shumës 1.1 mil.euro në vitin 2001, në 20.9 mil.euro në fund të vitit 2005:




VËSHTRIMI MBI AFARIZMIN E BANKËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2005

Kreditë në fund të vitit 2005 më së shumti janë shfrytëzuar nga ndërmarrjet e ndryshme me këtë strukturë:

a) Sipas Destinimit	Shuma €	Struktura
11 kredi për mjete themelore	1,004,102.41	4.79
435 kredi për mjete xhiruese	17,342,644.68	82.70
1825 kredi personave fizikë	2,624,296.84	12.51
Gjithsej:	<u>20,971,043.93</u>	<u>100.00 %</u>




b) Sipas veprimtarive	Shuma në Euro	Struktura
28 kredi për prodhim	2,368,454.61	11.19
310 kredi për tregti	13,085,915.04	62.40
59 kredi për shërbime	1,192,926.34	5.69
2 kredi për transport	29,284.00	0.14
5 kredi për bujqësi	14,076.00	0.07
28 kredi për hotelieri	565,610.10	2.70
14 kredi për ndërtimtari	1,090,481.00	5.20
1825 kredi personave fizikë	2,624,296.84	12.51
Gjithsej:	<u>20,971,043.93</u>	<u>100.00%</u>




b) Sipas Afatit	Shuma në Euro	Struktura
21 kredi deri 1 muaj	572,395.00	2.73
21 kredi 1 deri 6 muaj	655,161.00	3.12
644 kredi 6 deri 12 muaj	5,998,252.97	28.60
410 kredi 12 deri 18 muaj	2,230,576.95	10.64
1107 kredi 18 deri 24 muaj	9,010,122.75	42.96
68 kredi 26 deri 36 muaj	2,504,535.29	11.94
Gjithsej:	<u>20,971,043.93</u>	<u>100.00%</u>


VËSHTRIMI MBI AFARIZMIN E BANKËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2005



b) Sipas pronësisë	Shuma në Euro	Struktura
2 kredi ndërmarrjeve shoqërore	15,000.00	0.07
2269 kr. ndërm. private dhe pers. fizik	20,956,043.93	99.93
Gjithsej:	20,971,043.93	100.00%



b) Sipas Filialave	I (kreditë)		II (garancionet)		Gjithsej: I+II	
	Shuma €	Struk.	Shuma €	Shuma €	Struk.	
674 Prishtinë	6,817,287.11	32.51	335,513.15	7,152,800.26	32.70	
371 Gjakovë	4,160,182.00	19.84	404,823.24	4,565,005.24	20.87	
533 Pejë	5,197,915.00	24.79	6,500.00	5,204,415.00	23.79	
175 Prizren	1,636,715.51	7.80	144,466.00	1,781,181.51	8.14	
170 Mitrovicë	972,657.00	4.64	14,043.72	986,700.72	4.51	
244 Gjilan	1,717,451.43	8.19		1,717,451.43	7.85	
170 Ferizaj	468,835.88	2.24		468,835.88	2.14	
Gjithsej:	20,971,043.93	100.00%	905,346.11	21,876,390.04	100.00%	



Duke pasur parasysh nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe rënien e aftësive kredituese të huamarrësve, Banka ka zhvilluar procedurën e kreditimit me shumë kujdes për të minimizuar riskun kreditor.

Mirëpo, për shkak të vështirësimit të kushteve të afatizimit që nga viti 2003, disa huamarrës patën probleme financiare dhe filluan të mos i paguajnë anuitetet e kredive me kohë dhe Banka u detyrua të bëjë padi gjyqësore në bazë të hipotekës në pasurinë e patundshme e më pak në bazë të pengut. Janë paditur 81 huamarrës në shumë prej: 758.791. euro. Përmbarimi i procesit gjyqësor është ngadalsuar por shpresohet në suksesin e tij. Disa huamarrës të paditur kanë bërë pagesën e borxhit sipas marrëveshjes jashtë gjyqësore.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të kredive të bankave komerciale në Kosovë u realizua në fund të vitit 2005 më 4.03%. Me Planin e biznesit për vitin 2006 është planifikuar rritja e pjesëmarrjes në 7.60%.

3.4 Qarkullimi i pagesave

Qarkullimi i pagesave gjatë vitit 2005 është kryer përmes Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (kliringu) dhe bankave korrespondente (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit).

a) Shuma e qarkullimit të pagesave të brëndshme midis bankave komerciale përmes BPK-së (kliringu) është në rritje të vazhdueshme prej vitit në vit dhe në fund të vitit 2005 ka arritur në 136.6 mil euro ose për 5.2% më shumë se në vitin e kaluar. Nga kjo shumë, 58.8 mil. euro janë realizuar përmes transfertës hyrëse të mjeteve për 23.217 transaksione. Ndërsa, pjesa tjetër e shumës prej 77.8 mil euro është realizuar përmes transfertës dalëse të mjeteve për 14.655 transaksione.

Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në shumën e përgjithshme të transaksioneve bankare përmes BPK-së në fund të vitit 2005 është realizuar më 7.1% ndërsa në numrin e përgjithshëm të transaksioneve më 7.2%.

b) Qarkullimi i pagesave me botën (transferta e mjeteve nga jashtë dhe jashtë vendit) në vitin 2005 është realizuar në shumën prej 107.4

mil. euro ose më pak se në vitin e kaluar për 7.4%, nëpërmes të tri bankave korrespondente:

LHB Internacional Handelsbank,
Frankfurt, Gjermani;
BASH Banka Amerikane e Shqipërisë,
Tiranë, Shqipëri.
RZB Raiffeisen Zentralbank Oestreich AG,
Vjenë, Austria.

Transferta e mjeteve jashtë vendit bëhet në mënyrë të shpejtë me anë të bartjes elektronike (LHB e RZB me internet, BASH bartje automatike me sistemin ON-LINE).

Transferta e mjeteve në kuadër të shteteve europiane është bërë brënda 24 orëve, kurse për shtetet jashtë Evropës brënda 48 orëve. Ndërsa, transferata e mjeteve nëpërmes të BASH bëhet menjëherë brënda disa minutave për klientët e të dy bankave.

Pjesëmarrja e Bankës në shumën e përgjithshme të transfertës hyrëse të mjeteve në nivel të bankave komerciale në Kosovë, në fund të vitit 2005 është realizuar më 5.3%, ndërsa e transfertës dalëse të mjeteve më 4.5%.

Me Planin e biznesit për vitin 2006 është parashikuar rritja e vazhdueshme e pjesëmarrjes së Bankës në bilancin e pagesave të Kosovës:

Eksportet	7.6%
Importet	13.6%

c) Banka ka të instaluar sistemin ON-LINE me të gjitha degët që mundëson kryerjen e menjëherëshme të shërbimeve të klientëve, pavarësisht se në cilën degë të Bankës e kanë të hapur llogarinë bankare.

Qarkullimi i pagesave në llogarinë e klientit dhe midis klientëve në tërë rrjetin e degëve të Bankës bëhet gratis. Banka i stimulon klientët për shërbimet e transfertës së mjeteve në valuta të tjera jashtë vendit pa provision për konvertim të euros në valuta tjera.

3.5 Të ardhurat dhe shpenzimet

Banka ka realizuar të ardhurat e përgjithshme në shumën prej 4.6 mil euro në fund të vitit 2005 përkatësisht për 26.7% më shumë se në vitin e

kaluar.

Pjesëmarrjen më të lartë në shumën e të ardhurave të përgjithshme e kanë:

të ardhurat nga interesi në kreditë e dhëna	60.0%
të ardhurat nga komisionet për kreditë e dhëna	9.6%
të ardhurat nga interesat për mjetet e lira ditore në bankat korrespondente	5.4%
të ardhurat nga komisionet për transfertën e mjeteve jashtë vëndit, garancione dhe L/K	7.3%
të tjera	17.7%

Të ardhurat nga interesat në kreditë e dhëna, së bashku me të ardhurat nga institucionet financiare vëndase dhe të huaja janë realizuar në shumën prej 3.014 mijë euro. Në krahasim me vitin e kaluar janë rritur për 31.8%. Nëse këto të ardhura i zvogëlojmë për shpenzimet e interesave në depozita me afat në shumën prej 805 mijë euro, atëherë të ardhurat neto nga interesat janë realizuar në shumë prej 2.209 mijë euro dhe në krahasim me vitin e kaluar shënojnë rritje për 20.7%. Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në shumë prej 4.2 mil euro në fund të vitit 2005 dhe janë rritur për 49.3% në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rritje e lartë rezulton nga rritja shumë e lartë e rezervës së riskut për kreditë në shfrytëzim dhe ato të paditura, përkatësisht nga 453.458 euro në vitin e kaluar në 1.180.712 euro në fund të vitit 2005.

Pjesëmarrjen më të lartë në shumën e shpenzimeve të përgjithshme në fund të vitit 2005, e kanë:

rezervimet për kreditë në shfrytëzim dhe të paditura gjatë vitit	7.9%
të ardhurat personale bruto	23.7%
interesi në depozita me afat qiratë	19.1%
amortizimi i mjeteve themelore	7.8%
të tjera	4.9%
	16.6%

Rritja shumë e lartë e shpenzimeve për rezervimet e kredive në shfrytëzim dhe atyre të paditura gjatë vitit, për 160.4% në fund të vitit 2005 në krahasim me vitin e kaluar dhe për 118.7% në krahasim me rritjen e planifikuar të tyre për vitin 2005, ndikoi më së shumti në realizimin e neto fitimit në shumë prej 368.282 euro, i cili ishte për 53.6% më i ulët se në vitin e kaluar dhe për 65.7% në krahasim me parashikimin për vitin 2005. Mirëpo, ndërmarrja e aktiviteteve të duhura në vitin 2006 për arkëtimin e kredive të vonuara dhe të paditura do të ndikoi në zvogëlimin e rezervës së riskut dhe në rritjen e të ardhurave, përkatësisht në rritjen e fitimit gjatë vitit 2006.

Banka ka paguar tatimin në fitim në shumën prej 92.070 euro, përkatësisht 20% në fitimin bruto për vitin 2005.

Banka në fund të vitit 2005 ka realizuar këta:

TREGUESIT KRYESORË	
Raporti i fitimit neto mbi aktivet (ROA)	0.8%
Raporti i fitimit neto mbi aktivet me risk (RORA)	1.2%
Raporti i fitimit neto mbi kapitalin në fund të vitit (ROE)	6.1%
Raporti i kapitalit(klasa1) mbi aktivet	13.2%
Shpenzimet e përgjithshme në raport me të ardhurat e përgjithshme	92.0%

3.6 Zgjerimi dhe modernizimi

Banka Ekonomike që nga liçensimi dhe rifillimi i punës në qeshor të vitit 2001 e deri në fund të vitit 2005 ka hapur 7 degë, 2 nëndegë dhe 16 zyra në tërë Kosovën.

Degët janë hapur në 7 qendrat kryesore të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Ndërsa, ekspoziturat janë të hapura në Istog (Burim) dhe Rahovec, kurse zyrat janë të hapura në tërë Kosovën, kryesisht në pikat doganore dhe regjistrimit të automjeteve.

Me zgjerimin e rrjetit të Bankës janë krijuar kushtet për rritjen e shërbimeve bankare:

depozitat, kreditë për persona juridik e individual, qarkullimi i pagesave të ndryshme dhe shërbimeve të tjera bankare, duke rritur edhe pjesëmarrjen në tregun bankar.

Gjatë vitit 2005 ka filluar realizimi i Projektit për blerjen, montimin dhe funksionimin e sistemit të bankomatave me POS terminale në tërë rrjetin e degëve të Bankës, i cili do të përfundojë në mars-prill të vitit 2006 me lansimin e kartelës debitore më vonë të kartelës kreditore dhe E-Banking sistemit. Deri në fund të vitit 2005 është zëvendësuar serveri me një të avancuar dhe me kapacitet shumë më të madh i cili do të mundësojë vazhdimin e avantazhit të Bankës Ekonomike në sistemin "ON-LINE" të pagesave në tërë rrjetin me degë e nëndegë.

Që nga viti 2004, klientët e Bankës Ekonomike në bashkëpunim me Bankën Amerikane të Shqipërisë janë duke përdorur kartelën American Express.

Rritja e Bankës ka imponuar kalimin në lokalet e reja, më të mira dhe më të mëdha në qendër të Prishtinës, gjatë muajit qeshor të vitit 2005.



KËSHILLI DREJTUES

Bardhyl Minxhozi
Kryetar

Ali Buza
Zëv. kryetar

Hasan Hajdari
anëtar

Raif Rexhepi
anëtar

Xhabir Kajtazi
anëtar

Qerim Ramadani
Anëtar

Gazmend Tuzi
Anëtar

Ismet Gjoshi
Anëtar

Hajrullah Zaiti-drejtor i përgjithshëm i bankës
Anëtar

DREJTUESIT

Hajrullah Zaiti
Drejtor i përgjithshëm

Mazllom Beqa
Zëvendës drejtor i përgjithshëm

Arbnor Pajaziti
Ndihmës drejtor I përgjithshëm për IT

Syzane Kaçaniku
Ndihmës drejtore e përgjithshme dhe Drejtore e Drejtorisë financiare

Ismet Gashi
Drejtor i Drejtorisë së kreditimit

Xhelal Kusari
Drejtor i Drejtorisë për punë juridike dhe të përgjithshme

Enver Vula
Shef i revizionit të brëndshëm

Teki Ukmata
Drejtor, Dega Prishtinë

Nurije Haxhikadrija
Drejtor, Dega Gjakovë

Izet Mahmuti
Drejtor, Dega Pejë

Hysein Kendos
Drejtor, Dega Prizren

Eset Shaqiri
Drejtor, Dega Mitrovicë

Nazmi Dushi
Drejtor, Dega Ferizaj

Selami Shala
Drejtor, Dega Gjilan

BANKAT KORRESPONDENTE

LHB Internationale Handelsbank
Frankfurt, Gjermani

ABA Amerikan Bank of Albania
Tiranë, Shqipëri

RZB Raiffeisen Zentral Bank Oesterreich
Vjenë, Austri



KPMG Albania Sh.p.k.
Deshmoret e 4 Shkurtit
P.O.Box 8264
Tirana, Albania

Telephone: +355 4 235532/3
Telefax: +355 4 235534
E-Mail: gboga@kpmg.com

Raport i auditorit te pavarur per aksioneret e Banka Ekonomike Sh.a. Prishtine

Ne u angazhuam per auditimin e bilancit te Banka Ekonomike Sh.a. Prishtine ("Banka") sipas 31 Dhjetor 2005, dhe pasqyrave te te ardhurave dhe shpenzimeve, te levizjes ne kapital dhe te fluksit te parave. Keto pasqyra jane pergjegjesi e menaxhmentit te Bankes.

SiF pershkruhet ne shenimin 2 (I) Banka ka perlllogaritur zhvleresimin e kredive bazuar ne perqindje fikse sipas periudhave te voneses. Gjithashtu, per nje numer kredish Banka ka zbatuar perqindje fikse percaktuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave te Kosoves ne perfundim te inspektimit te fundit te zhvilluar gjate vitit 2005. Per pasoje, Banka ka rregjistruar zhvleresim specific per kredi te cilat mund te mos kene qene te zhvleresuara ne 31 Dhjetor 2005. Per me teper per kredite per te cilat treguesit e zhvleresimit mund te identifikohen sipas 31 Dhjetor 2005 Banka nuk ka konsideruar fluks te ardhshem parash nga mbledhja e kolateralit per perlllogaritjen e vleres se mbledhshme te kredive. Ky trajtim kontabel, ne opinionin tone nuk eshte ne perputhje me Standartin Nderkombetar te Kontabilitetit ("SNK") Nr. 39, "Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja". Ne mungese te perlllogaritjeve alternative te vleres se mbledhshme te kredive ne perputhje me SNK 39, ne nuk jemi ne gjendje te percaktojmë shumen e reserves per zhvleresimin e kredive ne 31 Dhjetor 2005 dhe humbjet nga zhvleresimi i kredive per vitin e mbyllur ne te njejten date.

SiF pershkruhet ne shenimin 2 (g) Banka ka njohur te ardhurat nga tarifat dhe komisionet nga aktiviteti i kredidhenies ne baze te parimit te arketimit. Keto tarifa dhe komisione ne shumen prej EUR 408 mije per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005 perfaqeson tarifa te marra ne momentin e dhenies se kredive, te cilat ne perputhje me SNK Nr. 18 "Te ardhurat", dhe bashke me kostot direkte qe u perkasin, duhet te shtyhen duke u njohur efekti i tyre ne normen effective te interesit te instrumentit perkates. Si pasoje e sa me siper dhe ne mungese te perlllogaritjeve te sakta nga ana e Bankes te shumes qe duhet shtyre ne vite te ardhshme, ne nuk jemi ne gjendje te percaktojmë shumen sipas te ciles balanca e kredive sipas 31 Dhjetor 2005 dhe te ardhurat nga tarifat dhe komisionet per vitin e mbyllur ne kete date jane te mbivleresuara.

Ne perputhje me Standartin Nderkombetar te Raportimit Financiar ("SNRF") Nr. 1: "Adoptimi per Here te Pare te Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar", Banka eshte adoptuese e pare e SNRF per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005 sepse Banka nuk ka pasqyra te pergatitura ne perputhje me SNRF per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2004. Ne nuk kemi audituar pasqyrat e Bankes sipas 1 Janar 2004 si dhe te dhenat per vitin 2004 per paraqitura ne pasqyrat financiare te bashkangjitura. Per pasoje, ne nuk jemi ne gjendje te gjykojmë ne llihdje me sakesine e aplikimit te politikave kontabel dhe te te balancave te paraqitura ne pasqyra financiare per vitin 2004 si dhe per momentin e tranzicionit qe eshte 1 Janar 2004. Ne nuk jemi ne gjendje te percaktojmë nese ndonje rregullim eshte i nevojshem per shumet e paraqitura ne pasqyra financiare per vitin 2004 si dhe shenimeve qe tregojne tranzicionin nga standartet e meparshme ne SNRF.

Per pasoje te Feshtjeve te diskutuara me siper ne nuk shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare.

KPMG Albania Sh.p.k.

25 Prill 2006

Prishtina

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

Në EUR '000

<i>Shënime</i>	<i>2005</i>	<i>2004</i>
		pa audituar ¹
Të ardhurat nga interesat	3,084	2,309
Shpenzimet për interesat	(805)	(456)
Të ardhurat neto nga interesat	3	1,853
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	0	1,225
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet	(74)	(103)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	1,279	1,122
Të ardhura të tjera operacionale	5	121
Rezultati neto nga këmbimet valutore	34	(36)
Humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	11	(453)
Shpenzime të tjera operacionale	6	(1,613)
Fitimi para tatimit	460	994
Tatimi mbi fitimin	0	(200)
Fitimi neto i periudhës	368	794

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet lexuar së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 24 deri në faqen 45.

Keto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të Bankës më 15 Prill 2006 dhe u nënshkruan nga përfaqësuesit si më poshtë:

Hajrullah Zaiti
Drejtor Ekzekutiv

Syzana Kacaniku
Drejtoreshë Financiare

¹ Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2004 janë përgatitur me baze të ndryshme nga SNRF. Ato pasqyra janë audituar nga Deloitte & Touche Sh.p.k.

Bilanci Kontabël më 31 Dhjetor 2005

Në EUR '000

	<i>Shënime</i>	<i>31-Dec-05</i>	<i>31-Dec-04</i>
pa audituar			
Aktivet			
Para ne arkë dhe në banka	8	4,946	4,894
Llogaritë me Bankën Qëndrore	9	6,724	4,935
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	10	11,121	10,041
Hua dhe paradhënie klientëve	11	21,171	16,601
Aktive të tjera		59	97
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	12	1,225	648
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	13	54	72
Totali i aktiveve		45,300	37,288
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	15	36,637	29,044
Tatim i pagueshëm		28	56
Detyrime të tjera	16	143	164
Totali i detyrimeve		39,311	31,767
Kapitali i aksionerëve			
Kapitali aksioner		4,725	4,725
Rezerva e përgjithshme		102	102
Fitimi i pashpërndarë		1,162	794
		5,989	5,621
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit të aksionerëve		45,300	37,288

Bilanci duhet lexuar së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 24 deri në faqen 45.

¹ Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2004 janë përgatitur me baze të ndryshme nga SNRF. Ato pasqyra janë audituar nga Deloitte & Touche Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

Në EUR '000

	<i>Kapitali aksioner</i>	<i>Rezerva e përgjithshme</i>	<i>Fitimi i pashpërndarë</i>	<i>Totali</i>
Më 31 Dhjetor 2003 (pa audituar)	3,912	-	508	4,420
Kapital i paguar	407	-	-	
Shpërndarja e fitimit	406	102	(508)	-
Fitimi i periudhës	-	-	794	794
Më 31 Dhjetor 2004 (pa audituar)	4,725	102	794	5,621
Fitimi i periudhës	-	-	368	368
Më 31 Dhjetor 2005	4,725	102	1,162	5,989

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 24 deri në faqen 45.

¹ Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2004 janë përgatitur me baze të ndryshme nga SNRF. Ato pasqyra janë audituar nga Deloitte & Touche Sh.p.k.

Pasqyra e fluksit të parase për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005

Në EUR '000

	<i>Shënime</i>	<i>2005</i>	<i>2004</i>
Fluksi i parase nga aktivitetet operacionale			pa audituar
Fitimi para tatimit		460	994
Korigjime për të barazuar fitimin me fluksin neto nga aktivitetet operacionale:			
Zhvlerësimi	13	179	165
Amortizimi	12	28	26
Humbje nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	11	1,181	453
Humbje nga nxjerrja nga përdorimi i mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara		1	-
Të ardhurat nga interesat	3	(3,084)	(2,309)
Shpenzimet për interesat	3	805	456
		(430)	(215)
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale:			
Rritje në lloagritë me Bankën Qëndrore		(733)	(748)
Rritje në hua dhe paradhënie institucioneve financiare		-	(2,037)
Rritje në hua dhe paradhënie klientëve		(5,670)	(4,764)
Rritje (ulje) në aktive të tjera		38	(57)
Rritje në hua dhe paradhënie nga institucionet financiare		-	2,500
Rritje në detyrimet ndaj klientëve		7,482	7,218
Rritje (ulje) në detyrimet e tjera		79	(17)
Tatimi mbi fitimin i paguar	7	(120)	(214)
Interesi i marrë		3,003	2,303
Interesi i paguar		(694)	(378)
Fluksi neto nga aktivitetet operacionale		3,385	3,591
Fluksi i mjeteve monetare për aktivitet investuese			
Blerja e mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara	13	(757)	(170)
Blerja e mjeteve të qëndrueshme të patrupëzuara	12	(10)	(25)
Fluksi neto për aktivitetet investuese		(767)	(195)

¹ Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2004 janë përgatitur me baze të ndryshme nga SNRF. Ato pasqyra janë audituar nga Deloitte & Touche Sh.p.k.

Pasqyra e fluksit të parase për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2005 (vazhdim)

Në EUR '000

<i>Shenime</i>	<i>2005</i>	<i>2004</i>
		pa audituar
Fluksi i parase nga aktivitetet financuese		
Kapitali i paguar	-	407
Fluksi neto nga aktivitetet financuese	-	407
Rritje/(ulje) neto në para dhe ekuivalentet e saj	2,188	3,803
Paraja dhe ekuivalentet e saj, në fillim të vitit	14,156	10,353
Paraja dhe ekuivalentet e saj, në fund të vitit	19	14,156

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqrave, të paraqitura nga faqja 24 deri në faqen 45.

¹ Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2004 janë përgatitur me baze të ndryshme nga SNRF. Ato pasqyra janë audituar nga Deloitte & Touche Sh.p.k.

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

1. Të përgjithshme

Në përputhje me rregulloren e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës ("BPK"), Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë ("Banka") mori licensën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 Maj 2001 dhe filloi të operonete e saj më 5 Qershor 2001. Zyrat qendrore të Bankës ndodhen në Rr. Migjeni Nr 1, Prishtinë, Kosovo. Banka operon njëkohesisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve, nëpërmjet rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Më 31 Dhjetor 2005 Kapitali aksioner i Bankës është i ndarë në 18,457 aksione të zakonshme me vlerë EUR 256 secila, gjithsej EUR 4,725,031 (2004: EUR 4,725,031).

Më 31 Dhjetor 2005 Banka numëron 186 punonjës (2004: 155).

2. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

(a) Përputhshmëria me Statndartet Ndërkombëtare të Raportimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe të interpretimeve nga Komisioni i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar ("KIRFN") i po këtij Bordi (BSNK). Banka është adoptuese për here te pare e SNRF.

Kalimi në SNRF nuk ndikon në pozicionin financiar të Bankës më 31 Dhjetor 2004 dhe 1 Janar 2004 dhe as në performancën financiare dhe fluksin a parasë të Bankës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2004.

(b) Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë prezantuar në mijë EUR, që është gjithashtu dhe monedha funksionale e Bankës. Ato janë ndërtuar sipas parimit të kostos historike.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit e Bankës të gjykojnë, të vlerësojnë dhe të bëjnë supozime që kanë

ndikim në zbatimin e politikave dhe në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to bazohen në eksperiencat e kaluara dhe në faktorë të tjerë ndikues që gjykohen si të arsyeshëm për rrethanat. Rezultati përbën bazën për gjykime mbi vlerën e aktiveve dhe detyrimeve, vlerë që mund të mos jetë e tillë bazuar në burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto përllogaritje.

Përllogaritjet dhe supozimet e ndërlidhura rishihen herë pas here. Rishikimi i përllogaritjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën përllogaritja rishihet, nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat pasardhëse nëse rishikimi ndikon si në periudhën aktuale ashtu dhe në ato pasardhëse.

Gjykimet e bëra nga drejtuesit në aplikimin e SNRF-ve të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe përllogaritjet që mbartin rrezik të rëndësishëm të një rregullimi material në vitin pasardhës, diskutohen në noten (m).

Në vitin aktual, Banka ka adoptuar të gjithë Standartet dhe Interpretimet e reja të lëshuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe Komisioni i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar ("KIRFN") i po këtij Bordi (BSNK), të cilat janë të rëndësishme për operacionet e veta dhe efektive për periudhat kontabël duke filluar në 1 janar 2005. Adoptimi i këtyre standarteve të reja të rishikuara nuk shkaktoi ndryshime në politikat kontabël të Bankës.

Politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë të vijueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare dhe në përgatitjen e një bilanci hapeje sipas SNRF-ve më 1 janar 2004 me qëllimin e kalimit në SNRF.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, Interpretimet e Standarteve të reja të mëposhtme dhe amendimet të Standarteve ishin lëshuar por jo efektive dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare:

SNFR 6 Eksplorim për një Vlerësim të burimeve Minerale. Standarti përfshin domosdoshmërinë e dallimit midis aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara të cilat janë përdorur në eksplorimin dhe

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

- vlërësimin e burimeve minerale, dhe përcakton nivelin mbi të cilin testi i rrezikut të zhvlërësimit duhet kryer. Banka nuk kryen operacione të cilat do të ndikoheshin nga Standartet e reja.
- SNFR 7 Mjetet financiare: Informacione të publikuara. Standartet do të kërkojnë informacione të publikuara shtese në lidhje me mjetet financiare të Bankës. Ai zëvendëson informacionet e publikuara (IAS 30) në pasqyrat financiare të Bankës dhe Institucione Financiare të ngjashme dhe i aplikohet te gjitha Shoqerive që përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me SNRF. Banka konsideron qe informacionet e publikuara shtesë te kërkuara do të lidhen me rrezikun financiar të objektivave drejtues, politikave dhe proceseve.
- KIRFN 3 Te drejta emetimi. Interpretimi lidhet me kontabilitetin e nje pjesemarrresi ne skemat operacionale te tregtise Banka nuk ka operacione të cilat mund të ndikoheshin nga Standartet e reja.
- KIRFN 4 Përcaktimi nëse një marrveshje përmban një qera. Interpretimi kërkon qe marrveshje të vecanta të kontabilizohen si qera edhe pse nuk janë në formë legale të qerave. Banka nuk ka përfunduar akoma analizën e saj të ndikimit të Interpretimit të ri.
- KIRFN 5 Të drejtat mbi interesa të ardhura si rezultat i zhvendosjes, restaurimit dhe fonde të riaftësimit të ambjentit. Interpretimi trajton fondet e krijuara për qëllimin e rregullimit zhvendosjes, dhe shpenzime të ngjashme. Interpretimi nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës.
- KIRFN 6 Detyrime të lindura nga pjesmarrja në nje treg specifik - Sherbime komunale elektrike dhe Mjete Elektronike. Interpretimi trajton detyrimet e lindura nga direktivat e Bashkimit European duke rregulluar grumbullimin, trajtimin, rimarrje dhe nxjerrje nga perdorimi e pademshme per ambientin e mjeteve. Interpretimi nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës.
- KIRFN 7 Aplikimi i Rivendosjes sipas IAS 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacionare. Interpretimi përmban drejtim se si një Shoqëri mund të rivendosë pasqyrat financiare sipas IAS 29 në vitin e parë që identifikon ekzistencën e hiperinflacion në ekonomine e monedhes së tij funksionale. Interpretimi nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës.
- KIRFN 8 Qëllimi i IFRS 2. Interpretimi sqaron që Standarti IFRS 2 Pagesa te bazuara ne aksione, aplikohet në marrveshje sipas të cilave një njësi kryen pagesa te tilla ne kembim te asgjeje. Interpretimi nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës.
- KIRFN 9 Rishikimi i derivativeve te perfshira. Interpretimi sqaron që trajtimi i derivativeve vlerësohet nga njësia kur Shoqëria bëhet pëe harë të parë palë e kontratës, dhe rishikimi është i ndaluar në mos ka ndryshim në termat e kontrates, i cili të modifikoje në mënyrë të rëndësishme fluksin e parase që në të kundërt do kërkohej në kontratë. Interpretimi nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës.
- Amendime të SNK 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare - Informacion i publikuar mbi kapitalin. Sinjë përmirësim plotësues i lindur nga IFRS 7 (shih më sipër), standarti do kërkojë informacione shtese në lidhje me kapitalin e Bankës. Ky përmirësim do kërkojë në mënyrë të rëndësishme më tepër informacione të publikuara në lidhje me strukturën e kapitalit.
- Amendime të SNK 19, Përfitimet e Punonjësve - Fitimet dhe Humbjet Aktuaristike, Plane Grupi dhe

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

Informacione të publikuara. Përmirësimet përfshijnë një alternativë mbi fitimet dhe humbjet aktuaristike të cilat njihen plotësisht në momentin që lindin, jashtë pasqyres së të ardhurave dhe shpenzimeve. Banka nuk ka plane përfitimi të punonjësve që do të ndikohet nga përmirësimi.

Amendime të SNK 39 Mjete Financiare: Njohja dhe Matja - Kontabilizimi i mbrojtjes sa fluksit të parase nga njohja dhe matja e transaksioneve brenda grupit. Amendimi lejon kualifikimin e rrezikut të të monedhës së huaj të një transakcioni shumë të mundshëm të parashkuar, si zë mbrojtjes nëse kriteret e caktuara përmbushen. Ky amendim nuk është i rëndësishëm për operacionet e Bankës, sikundër Banka nuk ka transaksione brenda grupit të cilat mund të klasifikoheshin si zë mbrojtjes në pasqyrat financiare.

Amendime të SNK 39 Mjete Financiare: Njohja dhe Vlerësimi - Alternativa e vlerës së tregut. Amendimi kufizon klasifikimin e mjeteve financiare si " në vlerë tregu nëpërmjet fitimit ose humbjes". Banka nuk ka ndonjë mjet financiar i cili do të ndikohet nga amendimi.

Amendime të SNK 39 Mjete Financiare: Njohja dhe Vlerësimi dhe IFRS 4, Kontratat e Sigurimit - Kontratat e Garancisë Financiare. Amendimi kërkon garanci të cilat nuk janë kontrata sigurim për tu vlerësuar me vlerë tregu mbi njohjen fillestare. Banka nuk ka përfunduar akoma analizën mbi ndikimin e amendimit.

Amendime të IAS 21 Efektet e Ndryshimit në kursin e këmbimit - investime neto në një operacion në monedhë të huaj. Amendimi sqaron në cilat situata një kredi mund të jetë pjesë e raportimit të investimeve neto në një operacion në monedhë të huaj të një njësie, dhe monedha në të cilën ky zë mund të paraqitet. Aktualisht, Banka nuk ka zëra që përfshijnë investime neto në operacione monedhë të huaj që do ndikoheshin nga amendimi.

(c) Aktivet financiare

(I) Klasifikimi

Banka i klasifikon aktivet financiare në hua dhe paradhënie dhënë klientëve dhe institucioneve financiare.

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë me pagesa të përcaktuara dhe fikse, të

palistuar në tregjet aktive. Ato krijohen kur Banka huazon para me qëllime jo afatshkurtra fitimi.

(II) Njohja

Huatë dhe paradhëniet njihen në momentin e disbursimit të tyre.

(III) Matja

Kredite dhe paradhënie klienteve maten fillimisht me kosto duke përjashtuar tarifat e marra në momentin e dhenies së kredise. Në vazhdim këto kredi maten me metodën e amortizimit të koston duke zbritur humbjet nga renien e vleres.

Aktivitetet financiare të tjera maten me kosto historike duke përfshirë edhe kostot e transakcionit dhe korrigjohen vazhimisht për humbjen nga rënia në vlerë, kur ka të tillë. Humbja nga rënia në vlerë vlerësohet me metodën e norms effective të interesit. Kostoja amortizohet me metodën e norms efektive.

(IV) Instrumenta specifike

Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përbëhet nga paratë në arkë dhe banka si dhe nga depozitimet me maturitet nën tre muaj. Bazuar në përkufizimin e mësipërm, në këtë zë nuk përfshihet rezerva e detyrueshme, e cila nuk është e disponueshme për kryerjen e transaksioneve të përditshme të Bankës.

Hua dhe paradhënie klientëve dhe institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet paraqiten të korigjuara për rënien në vlerë për të reflektuar shumën e tyre të rekuperueshme (shiko politikën kontabël (1)).

(V) Nxjerrja nga bilanci

Një aktiv financiar nxirret nga bilanci kur Banka nuk posedon më të drejta kontraktuale mbi atë fenomenin që përbën aktivin. Kjo ndodh kur të drejtat realizohen, maturohen ose i nënshtrohen vendimit Gjyqësor jo pozitiv. Huatë nxirren nga bilanci në ditën e transferimit prej Bankes.

(d) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus rezervën për zhvlerësimin e akumuluar si dhe humbjet e mundshme nga rënia në vlerë (shiko politikën kontabël (1)).

Shpenzimet që ndodhin për zëvendësimin e një

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

komponenti të aktivitetit të regjistruar vecant kapitalizohen. Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohet vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Çdo shpenzim tjetër regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën që ndodhin.

Zhvlerësimi përaktivin dhe/ose pjesë të tij regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën zbritese gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar. Përmirësimet e objekteve me qera lidhen me lidhen me shpenzime të kryera mbi objektet e marra me qera dhe amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër midis jetëgjatësisë efektive të tyre dhe periudhës kontraktuale të qerasë. Jetëgjatësitë efektive për kategori të caktuara vijojnë si më poshtë:

Përmirësimet e objekteve me qera	5 vjet
Pajisje kompjuterike dhe të tjera	5 vjet
Automjete	5 vjet
Furnitura dhe pajisje	5 vjet

(e) Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivitetet e qëndrueshme të patrupëzuara paraqiten me kosto minus rezervën për amortizimin e akumuluar si dhe humbjet e mundshme nga rënia në vlerë (shiko politikën kontabël (1)).

Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohet vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Çdo shpenzim tjetër regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën që ndodhin.

Zhvlerësimi për aktivin dhe/ose pjesë të tij regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën zbritese gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar. Jetëgjatësitë efektive për kategori të caktuara vijojnë si më poshtë:

Programe kompjuterike	5 vjet
-----------------------	--------

(f) Detyrimet financiare

Detyrimet ndaj institucionet financiare dhe klientëve maten me kosto të amortizuara duke eprdorur metoden e interesit efektiv. Një detyrim financiar nxirret nga bilanci kur paguhet.

(g) Njohja e të ardhurave*(I) Të ardhurat nga interesat*

Të ardhurat nga interesat njohen kur maturohen

(sipas metodes se perlllogaritjes).

(II) Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin si rrjedhojë e shërbimeve të ofruara nga Banka. Njohja e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet bëhet në momentin që shërbimi bankar apo garancia ofrohet.

Tarifat dhe komisionet nga kreditimi njihen në momentin e arketimit.

(h) Shpenzimet për interesat*(I) Shpenzimet për interesat*

Shpenzimet për interesat përlllogariten me Yield-in efektiv të detyrimit dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shpenzimat për interesat përfshijnë amortizimin me normë efektive interesi të çdo lloj zbritjeje apo primi ose të tjera ndryshime midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim të detyrimit që sjell interes.

(II) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ato ndodhin.

(III) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kontributeve minimale për pensionet në Kosovë në kuadër të një plani të mirëpërcaktuar. Kontributet për sigurimet shoqërore njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato ndodhin.

(IV) Pagesat për qeranë operative

Pagesat e bëra për qeranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë.

(V) Shpenzimet për tarifat dhe komisionet

Shpenzimet për tarifat dhe komisionet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur shpenzimi respektiv përfitohet.

(i) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin apo humbjen e vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç se kur lidhet me elementë

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

që njihen direkt në Kapital. Në këtë rast edhe tatimi njihet në Kapital.

Tatimi aktual është tatimi për t'u paguar tek organet tatimore, i përlogaritur me normën tatimore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare si dhe duke përfshirë ndonjë korigjim të mundshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është rrjedhojë e diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për raportim financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi.

Shuma e tatimit të shtyrë bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Shuma e shtyre e taksave bazohet në realizimin apo shlyerjen e pritshme të vlerës kontabel të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat në fuqi të taksave.

Tatimi i shtyrë në aktiv njihet vetëm në rastin kur pritet të shkaktojë përfitime të tatueshme në të ardhmen si rrjedhojë e përdorimit të aktivitetit. Taksat e shtyra në aktive pakesohen në masën që benefiti prej tyre nuk është me i pritshëm të realizohet.

Tatime shtesë të lidhura me shpërndarjen e dividendëve njihen në të njëjtën kohë si detyrim në momentin që njihet detyrimi për pagesën e dividendët.

(I) Trasaksionet në monedhë të huaj

Trasaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit valuator në datën e kryesjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare që mbahen në monedhë të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave konvertohen në EUR me kursin në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Diferencat nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave financiare, konvertohen me kursin në datën e transaksionit. Ndërsa aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të ndryshme nga EUR, që maten me vlerë venale konvertohen me kursin e datës së përcaktimit të vlerës venale.

(m) Humbja nga rënia në vlerë

Vlera kontabël e aktiveve të Bankës, përveç tatimit të shtyrë (shiko politikën kontabël (i)) rishikohet në çdo moment raportimi për të korigjuar ndonjë rënie në vlerë. Në rast se evidentohet mundësi për rënie në vlerë, atëherë ripërcaktohet shuma e rekuperushme e aktivitetit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në rast se vlera kontabël e një aktivi apo vlera e flukseve që do të gjenerojë është më e madhe se vlera e rekuperueshme e aktivitetit. Humbje nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për një aktive që nuk gjeneron fluks para të pavarur, shuma e rikuperueshme vendoset për njësinë që gjeneron para dhe të cilin aktivi i përket.

Hua dhe paradhënie klientëve

Humbje nga rënia në vlerë përlogaritet mbi vlerën e disa huave dhe paradhënieve bazuar në përqindje fikse të përcaktuara nga BPK në perfundimin e inspektimit të fundit të kryer gjatë vitit. Për pjesën tjetër të huave, vlera e mbledhshme është përlogaritur si me e vogla e dy vleresimeve të mëposhtme:

(i) Vleresim bazuar në ditë vonesa (prishje e kotnrate)

Vlera kontabel e huave zvogelohet me përqindje fikse për të arritur të vlera e mbledhshme. Keto përqindje fikse janë bazuar në ditë vonesat si më poshtë:

Ditë vonesat	Përqindjet e aplikuar
0-30 ditë	1%
31-60 ditë	5%
61-90 ditë	20%
91-180 ditë	50%
Mbi 180 ditë	100%

(II) Vleresim bazuar në tregues zhvleresimi shtese

Vlera e mbledhshme bazuar në tregues shtese vleresohet kur Banka ka tregues shtese të zhvleresimit përveç ditë vonesave (prishjes së kontrates). Shuma e mbledhshme e huave dhe paradhënieve me kosto të amortizuara është llogaritur si vlera e tanishme e flukseve të ardhshme të parase, e aktualizuar me normën origjinale

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

efektive te interesit (psh interesi efektiv ne momentin e njohjes se ketyre instrumenteve financiare). Keto flukes te ardhshme te parase nuk perfshijne flukset e mundshme nga mbledhja e kolateralit.

Nje humbje nga renia ne vlere e huave dhe paradhenieve te mbajtura me kosto te amortizuar, kthehet nese rritja e mepasshme ne vleren e rikuperueshme te aktivitet eshte ne menyre objektive e lidhur me nje ngjarje qe ndodh pasi humbja eshte njohur. Ne rastin e huave te rezervuara sipas perqindjeve fikse te percaktuara nga BPK rikthimi behet kur kredia arketohet ose kur BPK i komunikon Bankes perqindje te reja fikse.

Aktive te matura me kosto

Vlera e mbledhshme e aktiveve te matura me kosto eshte me e madhja e cmimit neto te shitjes apo te vleres ne perdorim. Per te vleresuar vleren ne perdorim flukset e ardhme te parase diskontohen ne vleren e tanishme me normen e diskontit para tatimeve qe reflekton normen e rikut te aktiveve perkatese ne kushte aktuale te tregut. Humbja kthehet nese ka nje ndryshim ne vleresimet e perdorura ne vendosjen e vleres se mbledhshme. Nje humbje nga renia ne vlere kthehet vetem ne masen qe vlera e aktivitet nuk kalon vleren kontabel qe do te ishte paraqitur si neto nga zhvleresimi apo amortizimi, nese nuk do te ishte njohur ndonje humbje.

(o) Vleresime kontabel te rendesishme dhe gjykime ne aplikimin e politikave

Banka kryen perlllogaritje dhe ben supozime te cilat ndikojne shumat e raportuara te aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit te ardhshem financiar. Perlllogaritje dhe gjykime jane vazhdimisht te vleresuara dhe jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ndodhi të ardhshme të cilat konsiderohen si të arsyeshme në situata të caktuara.

Humbje nga renia në vlerë e huave dhe paradhenieve klientëve

Banka rishikon portofolin e saj të kredive për të vlerësuar rrezikun e zhvlerësimit në bazë mujore. Në përcaktimin nëse humbja nga renia në vlerë

duhet të regjistrohet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve, Banka ben gjykime nese ekziston ndonje e dhene e vzhgueshme tregues i nje renie te vleresueshme ne fluksin e ardhshem te perlllogaritur te parasë nga huate.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vzhgueshme që tregojnë praninë e nje përkeqësimi në gjendjen e pagesave të huamarrësve. Menaxhmenti përdor perlllogaritje të bazuara në ekperiencen historike të humbjes për aktivet që mbartin karakterisitka te ngjashme rreziku kredie.

(p) Krahasues

Informacioni krahasues është prezantuar në mënyrë të pandryshuar duke aplikuar politikat kontabel të Bankes. Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese riklasifikohen për qëllimin e krahasimit.

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

3. Të ardhurat nga interesat

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2005	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Të ardhura nga interesat:		
Hua dhe paradhënie klientëve	2,825	2,179
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	259	130
	3,084	2,309
Shpenzime për interesat:		
Detyrime ndaj klientëve	745	453
Detyrime ndaj bankave	60	3
	805	456
Të ardhurat neto nga interesat	2,279	1,853

4. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2005	2004 <i>pa audituar</i>
Shërbimet bankare	832	766
Huadhënia	408	342
Garancitë	113	117
Totali	1,353	1,225

Të ardhurat nga shërbimet bankare përbëhen nga komisionet për transfertat lokale dhe ndëkombëtare, për administrimin e llogarisë, çeqet dhe shërbime të tjera.

5. Të ardhura të tjera operacionale

Të ardhurat e tjera operacionale përbëhen si më poshtë:

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2005	2004 <i>pa audituar</i>
Arkëtimi i kredive të nxjerra jashte bilancit	115	121
Të ardhura të tjera	1	-
Totali	116	121

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

6. Shpenzime të tjera operacionale

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2005	2004 <i>pa audituar</i>
Shpenzimet e personelit	999	828
Qeraja	331	197
Zhvlerësimi	179	165
Amortizimi	28	26
Shërbime komunale dhe karburant	76	53
Shpenzime për komunikim	74	66
Shpenzime për udhëtime	68	48
Shpenzime marketingu dhe publiciteti	68	58
Shpenzime për kancelari	57	39
Riparime dhe mirëmbajtje	24	26
Shpenzime të sigurisë	18	11
Auditimi	17	20
Shpenzime printimi	15	15
Shpenzime për teknologjinë	8	6
Të tjera	105	55
Totali	2,067	1,613

Në shpenzimet e tjera bëjnë pjesë shpenzimet e përfaqësimit dhe anëtarësimit si dhe taksa të tjera të paguara nga Banka.

7. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në Kosovë vlerësohet 20% (2004: 20%) e fitimit të tatueshëm. Më poshtë paraqitet barazimi tatimit aktual mbi fitimin të llogaritur me normën në fuqi dhe shpenzimit për tatimin mbi fitimin.

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2005	2004 <i>pa audituar</i>
Fitimi para tatimit	460	994
Tatimi i llogaritur me normën 20%	92	199
Shpenzime të pazbritshme për qëllime tatimi		
Shpenzime publiciteti	-	1
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	92	200

Barazimi i tatimit të pagueshëm me tatimin e paguar për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2005 dhe 31 Dhjetor 2004 vijon si më poshtë:

	2005		2004	
			<i>pa audituar</i>	
Tatimi i pagueshëm më 1 Janar	56		70	
Tatimi i paguar gjatë vitit	(120)		(214)	
Shpenzimi për tatimin	92		200	
Tatimi i pagueshëm më 31 Dhjetor	28		56	

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

8. Arka dhe bankat

Arka dhe bankat vijonë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Paratë në arkë	4,270	3,520
Paratë në bankë	676	1,374
Totali	4,946	4,894

Paratë në banka lidhen me paratë në llogari rrjedhëse si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
LHB Internacionale Handelsbank, Gjermani	68	147
Raiffeisen Bank, Austri	228	770
American Bank of Albania, Shqiperi	380	457
Totali	676	1,374

Llogaritë rrjedhëse me LHB Internacionale Handelsbank nuk fitojnë interes. Llogaritë rrjedhëse në American Bank of Albania dhe Raiffeisen Bank fitojnë interes, mesatarisht me normën 1.452% në vitin 2005 (1.695 % në vitin 2004).

9. Llogaritë me BPK

Shuma prej EUR 6,724 mijë e depozituar në BPK më 31 Dhjetor 2005 (2004: EUR 4,935 mijë) përfshin rezervën e detyrueshme të likuiditetit sipas rregullores së këtij autoriteti. më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 kjo rezervë përbënte 10% të lloarive dhe depozitave të klientëve. Rezerva e detyrueshme në BPK ka fituar interes me normë 1% p.a. gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2005 (2004: 1% p.a.), ndërsa shumat mbi nivelin e reserves së detyrueshme (në llogari rrjedhëse) nuk fitojnë interes.

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Rezerva e detyrueshme	3,636	2,903
Llogaritë rrjedhëse me BPK	3,088	2,032
Totali	6,724	4,935

10. Hua dhe paradhënie institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet ndaj instituioneve financiare sipas kategorive:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Depozitat overnight	8,310	7,230
Depozitat	2,500	2,500
Llogari të tjera	307	307
Interesi i përlogaritur	4	4
Totali	11,121	10,041

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

Depozitat overnight me LHB Internacional Handelsbank kanë fituar interes me normë mesatare vjetore 2.33% gjatë vitit 2005 (2004: 0.93%).

Depozitat me LHB Internationale Handelsbank në Gjermani më 31 Dhjetor 2005 kanë maturitet 1 vjeçar (2004: 1 vjeçar). Më 31 Dhjetor 2005 depozitat me këtë bankë fitojnë interes vjetor me normë 2.8% (2004: 2.2 %).

Llogaritë e tjera përfaqësojnë llogari të bllokuara si garanci në American Bank of Albania për kartat American Express dhënë Bankës dhe klientëve të saj.

11. Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Hua afatgjata (me maturitet mbi 12 muaj)	13,768	9,532
Hua afatshkurtra	7,203	7,326
Overdraftet	1,147	11
Interesi i përlllogaritur	199	118
Rezerva për humbjet nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve	(1,146)	(386)
	21,171	16,601

Lëvizjet në rezervën për humbjet nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve vijojnë si më poshtë:

	2005	2004 <i>pa audituar</i>
Më 1 Janar	386	231
Humbja nga rënia në vlerë e huave dhe paradhënieve klientëve për vitin (neto nga rimarrjet)	1,181	453
Huatë e nxjerra jashtë bilancit	(421)	(298)
Më 31 Dhjetor	1,146	386

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

12. Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara detajohen si më poshtë (numrat për 2004 pa audituar):

	Përmirësimet e objekteve me qera	Furnitura, instalime dhe pajisje	Pajisje elektronike dhe kompjuterike	Automjete	Totali
Kosto					
Më 1 Janar 2004	230	394	250	8	882
Shtesa	5	69	76	20	170
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(1)	(1)
Më 31 Dhjetor 2004	235	463	326	27	1,051
Më 1 Janar 2005	235	463	326	27	1,051
Shtesa	8	591	83	75	757
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1)	(1)	-	(2)
Më 31 Dhjetor 2005	243	1,053	408	102	1,806
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 Janar 2004	53	101	83	2	239
Shpenzimi për vitin	55	66	40	4	165
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(1)	(1)
Më 31 Dhjetor 2004	108	167	123	5	403
Më 1 Janar 2005	108	167	123	5	403
Shpenzimi për vitin	48	74	49	8	179
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(1)	-	-	(1)
Më 31 Dhjetor 2005	156	240	172	13	581
Vlera kontabël, neto					
Më 1 Janar 2004	177	293	167	6	643
Më 31 Dhjetor 2004	127	296	203	22	648
Më 31 Dhjetor 2005	87	813	236	89	1,225

Përmirësimet e objekteve me qera lidhen me shpenzimet e kryera në degët Ferizaj, Prizren (në vitin 2002) Prishtinë, Pejë, Mitrovicë (në vitin 2003), në Gjilan (në vitin 2004) si dhe përmirësimet në vitin 2005 në degën e Prizrenit dhe Zyrat Qëndore.

Nuk ka aktive të bllokuara si garanci më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004.

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

13. Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 detajohen si më poshtë (numrat për 2004 të pa audituar):

	Programe Kompjuterike
Kosto	
Më 1 Janar 2004	107
Shtesa	25
Më 31 Dhjetor 2004	132
Më 1 Janar 2005	132
Shtesa	10
Më 31 Dhjetor 2005	142
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 Janar 2004	34
Shpenzimi për vitin	26
Më 31 Dhjetor 2004	60
Më 1 Janar 2005	60
Shpenzimi për vitin	28
Më 31 Dhjetor 2005	88
Vlera kontabël, neto	
Më 1 Janar 2004	73
Më 31 Dhjetor 2004	72
Më 31 Dhjetor 2005	54

14. Detyrime ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare më 31 Dhjetor 2005 vijojnë si më poshtë:

Banka	Shuma	Maturiteti	Norma e interesit (p.a.)
LHB Internacionale Handelsbank, Gjermani	2,503	12 muaj	2.8%
Totali	2,503		

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

Detyrimet ndaj institucioneve financiare më 31 Dhjetor 2004 vijojnë si më poshtë (pa audituar):

Banka	Shuma	Maturiteti	Norma e interesit (p.a.)
LHB Internacionale Handelsbank, Germany	2,503	12 muaj	2.35%
Totali	2,503		

15. Detyrime ndaj klientëve

Llogaritë e klientëve për bizneset, sipërmarrësit privatë dhe individët detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Llogaritë rrjedhëse		
Në EUR	10,751	9,651
Në monedhë tjetër	315	214
Dapozitat me afat		
Në EUR	25,195	18,873
Në monedhë tjetër	-	41
Interesi i përlogaritur	376	265
	36,637	29,044

Llogaritë rrjedhëse nuk fitojnë interes.

Interesat për depozitat më 31 Dhjetor 2005 vijojnë si më poshtë:

1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vjet	3 vjet	5 vjet
%	%	%	%	%	%	%	%
2.3	2.5	3.1	3.5-4.5	4.2	4.5	4.6-4.8	5

Interesat për depozitat më 31 Dhjetor 2004 vijojnë si më poshtë (pa audituar):

1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 vjet	3 vjet	5 vjet
%	%	%	%	%	%	%	%
1	2.5	2.5-2.75	3-3.5	4	-	-	5

16. Detyrime të tjera

Detyrimet e tjera përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004 <i>pa audituar</i>
Taksa të tjera të pagueshme	43	14
Sigurimet shoqërore	12	12
Shpenzime të përlogaritura	88	38
Totali	143	64

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

17. Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Bankës është i ndarë në 18,457 aksione të zakonshme me vlerë (më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004) EUR 256 secila, gjithësej EUR 4,725,031. Gjatë vitit 2004 kapitali aksioner u rrit me si rrjedhojë e përvetësimit të fitimit të pashpërndarë si dhe me EUR 406,271 si rrjedhojë e emetimit të aksioneve të reja për

likuiditete.

Në përputje me Rregulli XXI mbi "Kapitalit Minimal të Bankës" autorizuar nën Seksionin 5 të Rregullores 1999/21 të publikuar nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, kapitali minimal aksioner për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë EUR 4 milion.

Lista e aksionerëve kryesor të Bankës më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 vijon si më poshtë:

<i>Lista e aksionerëve</i>	Përqindja e pronësisë më 31 Dhjetor 2005 %	31 Dhjetor 2005 (në EUR '000)	Përqindja e pronësisë më 31 Dhjetor 2004 %	31 Dhjetor 2004 (në EUR '000) <i>(pa audituar)</i>
Behgjet Pacolli	49.09	2,320	38.37	1,813
Hasan Hajdari	13.10	619	13.10	619
Xhabir Kajtazi	8.57	405	8.57	405
Raif Rexhepi	7.87	372	7.87	372
Zyhra Hajdari	5.71	270	5.71	270
Ismet Gjoshi	4.23	200	4.23	200
Qerim Ramadani	3.33	157	3.33	157
Selim Pacolli	1.73	82	1.73	82
Elkos	1.60	76	1.60	76
Union	0.67	31	0.67	31
Ibrahim Bytyqi	0.63	30	0.63	30
Nesret Gashi	0.58	27	0.58	27
Gafur Neziri	0.50	24	0.50	24
Lesna	0.27	13	0.27	13
Dukagjini operative	0.26	12	0.26	12
Hc 'Jatex'	0.22	11	0.22	11
Elektromotorri	0.20	9	0.20	9
Intergrafika	0.16	8	0.16	8
Emin Duraku	0.15	7	0.15	7
Union VI	0.13	6	0.13	6
Valoni Impex	0.13	6	0.13	6
Inova	0.10	5	0.10	5
Hc 'Metaliku'	0.09	4	0.09	4
Komtel Project Engineering	-	-	3.73	176
Baton Arifi	-	-	2.40	113
Sadudin Humolli	-	-	2.40	113
Hysni Hoti	-	-	2.19	104
Të tjerë	0.68	31	0.68	31
	100.00	4,725	100.00	4,725

18. Rezerva e përgjithshme

Bazuar në vendimin e Bredit të Drejtorëve të Bankës dhe aprovimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve më 28 Prill 2004, fitimi i pashpërndarë më 31 Dhejtor 2003 EUR 507,771 u përvetësua i tëri më 8 Qershor

2004. Shuma prej EUR 406,217 iu shpërnda aksionerëve të vjetër në formën e aksioneve të reja dhe pjesa tjetër prej EUR 101,554 kaloi në Rezerva e përgjithshme.

Qëllimi i rezervës së përgjithshme është të mbulojë risqet e përgjithshme me të cilat përballet Bankat gjatë aktivitetit të saj normal.

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

19. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj detajohen si më poshtë:

	Vitet që mbyllen më 31 Dhjetor	
	2005	2004
		<i>pa audituar</i>
Paratë në arkë dhe në banka	4,946	4,894
Llogaritë rrejdhëse në Bankën Qendrore	3,088	2,032
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare me maturim nën tre muaj	8,310	7,230
Totali	16,344	14,156

20. Garanci dhe angazhime

Garancitë dhe angazhimet përfshijnë garancitë marra nga klientëve. Bilanci më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 detajohet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
		<i>pa audituar</i>
Të siguruara me depozita	86	-
Të sigurura me letra garancie	147	194
Të siguruara me hipoteka e te tjera	792	519
Totali	1,025	713

Garancitë e marra nga institucionet financiare përfshijnë shumën EUR 147 mijë, garanci e marrë nga LHB Internationale Handelsbank AG, në Gjermani.

Banka emeton garanci në favour të klientëve të saj. Këto instrumenta i nënshtrohen riskut të kre-disë ashtu edhe si huatë e disbursura. Sipas vlerësimit të drejtuesve të Bankës, nuk pritet të ndodhë të ndodh dem material lidhur me garancitë në fuqi më 31 Dhjetor 2005 dhe rrjedhimisht nuk do të krijohet rezerva për të tilla

humbje në pasqyrat financiare.

Çështjet gjyqësore

Gjatë aktivitetit normal të saj Banka përballet me pretendime ndaj/të palëve të treta dhe çështje gjyqësore. Sipas opinionit të drejtuesve të Bankës zgjidhja e këtyre çështjeve gjyqësore nuk do të ketë ndikim në rezultatin financiar të Bankës.

Angazhim kontraktuale për qeranë operacionale

	31 Dhjetor 2005	31 Dhjetor 2004
		<i>pa audituar</i>
Më pak se 1 vit	351	206
Nga 1 deri në 5 vjet	787	305
Totali	1,138	511

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

22. Administrimi i riskut financiar

Për shkak të natyrës së tyre, aktivitetet e bankave lidhen kryesisht me përdorimin e instrumentave financiarë. Instrumenti financiar është çdo kontratë që çon në lindjen e të drejtave për arkëtim parash apo aktive të tjera financiare nga një pale e tretë (aktiv financiar), ose në lindjen e detyrimit për të paguar para apo dorëzuar aktive të tjera financiare një pale të tretë (detyrim financiar). Instrumentat financiarë shfaqin nivele të caktuara risku për Bankën. Risku më i rëndësishëm që lidhet me instrumentat financiare diskutohet në vijim.

(I) Risku i normës së interesit

Operacionet e Bank i nënshtrohen riskut që vjen nga fluktacionet e normës së interesit për sa

kohë aktivet dhe detyrimet që sjellin interes maturohen apo rriçmohen në momente kohore dhe/ose në shuma të ndryshme. Për të reduktuar riskun e normës së interesit Banka monitoron vazhdimisht lëvizjet e tregut financiar.

Megjithatë efekti aktual ndikohet edhe nga faktorë të tjerë, duke përfshirë këtu mundësinë e kryerjes së pagesave më pare ose më vonë se datat kontraktuar, variacionet në ndjeshmërine e rriçmimit ndaj normës së interesit si dhe monedhat e ndryshme.

(a) Informacion për Yield-in efektiv

Tabela e mëposhtme paraqet Yield-et efektive mesatare për për katgaoritë më të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2005 dhe 2004 (2004 i pa audituar):

	Norma mesatare e ponderuar e Interesit (EUR)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (USD)		Norma mesatare e ponderuar e interesit (CHF)	
	2005	2004	2005	2004	2005	2004
31 Dhjetor						
Aktivitet						
Arka dhe bankat	-	-	2.15	1.65	-	-
Llogaritë me Bankën Qendrore	1	1	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie institucioneve	2.23	2.06	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	14.66	15.73	-	-	-	-
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	2.8	2.35	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	3.53	3.10	0.7	-	0.43	-

(b) Analiza e rriçmimit të normave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet momentet e rriçmimit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës. Aktivitet dhe detyrimet me norma interesi fikse janë raportuar në përputhje me datat e ripagimit së tyre.

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

31 Dhjetor 2005							
	Deri në 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Nuk fitojnë interes	Totali
Aktivët							
Arka dhe bankat	608	-	-	-	-	4,338	4,946
Llogaritë me Bankën Qendrore	-	-	-	-	3,636	3,088	6,724
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	8,310	-	-	2,500	-	311	11,121
Hua dhe paradhënie klientëve	1,694	310	316	5,727	12,141	983	21,171
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	59	59
Totali	10,612	310	316	8,227	15,777	8,779	44,021
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	-	-	-	2,500	-	3	2,503
Detyrime ndaj klientëve	2,834	3,445	6,277	9,413	3,226	11,442	36,637
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	171	171
Totali	2,834	3,445	6,277	11,913	3,226	11,616	39,311
Pozicioni neto	7,278	(3,135)	(5,961)	(3,686)	12,551	(2,837)	4,710
Pozicioni neto kumulativ	7,278	4,643	(1,318)	(5,004)	7,547	4,710	-

31 Dhjetor 2004 (pa audituar)							
	Deri në 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 Muaj	6-12 Muaj	Mbi 1 vit	Nuk fitojnë interes	Totali
Aktivët							
Arka dhe bankat	1,227	-	-	-	-	3,667	4,894
Llogaritë me Bankën Qendrore	-	-	-	-	2,903	2,032	4,935
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,230	2,500	-	-	-	311	10,041
Hua dhe paradhënie klientëve	1,748	327	1,193	3,683	9,532	118	16,601
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	97	97
Totali	10,205	2,827	1,193	6,683	12,435	6,225	36,568
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	-	-	-	2,500	-	3	2,503
Detyrime ndaj klientëve	-	2,118	16,796	-	-	265	29,044
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	120	120
Totali	10,205	2,118	16,796	2,500	-	10,253	31,667
Pozicioni neto	10,205	(709)	(15,603)	1,183	12,435	(4,028)	4,901
Pozicioni neto kumulativ	10,205	(10,914)	(4,689)	(3,506)	(8,929)	4,901	-

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

(ii) Risku i normave të këmbimit valutor

Kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj ekspozon Bankën kundrejt riskut që vjen nga fluktacionet kursit të këmbimit. Meqënëse pasqyrat financiare prezantohen në EUR, lëvizjet e kursit të këmbimit të monedhave të tjera kundrejt EUR kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës. Ekspozimi ndaj transaksioneve vjen nga prezenca

e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të ndryshme nga ajo e prezantimit të pasqyrave financiare (në këtë rast: EUR). Fitimet/(humbjet) e krijuara regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të ndryshme nga EUR më 31 Dhjetor 2005 vijon si më poshtë:

(Në EUR)

	31 Dhjetor 2005			
	EUR	USD	CHF	Totali
Aktivet				
Arka dhe bankat	4,267	629	50	4,946
Llogaritë me Bankën Qendrore	6,724	-	-	6,724
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	11,121	-	-	11,121
Hua dhe paradhënie klientëve	21,171	-	-	21,171
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	1,225	-	-	1,225
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	54	-	-	54
Aktive të tjera	59	-	-	59
Totali i aktiveve	44,621	629	50	45,300
Detyrimet dhe kapitali i aksionerëve				
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,503	-	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	36,322	253	62	36,637
Detyrime të tjera	171	-	-	171
Kapitali aksioner	4,725	-	-	4,725
Rezerva e përgjithshme	102	-	-	102
Fitimi i pashpërndarë	1,162	-	-	1,162
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	44,985	253	62	45,300
Pozicioni valuator neto më 31 Dhjetor 2005	(364)	376	(12)	-

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të ndryshme nga EUR më 31 Dhjetor 2004 vijon si më poshtë:

(Në EUR)

	31 December 2004 (pa audituar)			
	EUR	USD	CHF	Total
Aktivet				
Arka dhe bankat	4,444	397	53	4,894
Llogaritë me Bankën Qendrore	4,935	-	-	4,935
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	10,041	-	-	10,041
Hua dhe paradhënie klientëve	16,601	-	-	16,601
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	648	-	-	648
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	72	-	-	72
Aktive të tjera	97	-	-	97
Totali i aktiveve	36,838	397	53	37,288
Detyrimet dhe kapitali i aksionerëve				
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,503	-	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	28,789	203	52	29,044
Detyrime të tjera	120	-	-	120
Kapitali aksioner	4,725	-	-	4,725
Rezerva e përgjithshme	102	-	-	102
Fitimi i pashpërndarë	794	-	-	794
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	37,033	203	52	37,288
Pozicioni valuator neto më 31 Dhjetor 2004	(195)	194	1	-

(iii) Risku i kreditimit

Aktiviteti i kreditimit dhe ndërmjetësimi financiar e ekspozon Bankën ndaj riskut të kreditimit. Në këtë kontekst risku qëndron në mundësinë e mosplotësimit të angazhimeve kontraktore nga palët e treta. Administrimi i këtij risku kryet nëpërmjet analizave periodike të rentabilitetit të huamarrësve të ndryshëm si dhe klasifikiminn e tyre sipas riskut që mbartin. Një formë e drejtpërdrejtë e administrimit të riskut të kreditimit është përfitimi i kolateraleve dhe garancive të tjera. Risku kryesor lind nga huatë dhe paradhëniet. Vlera e ekspozimit është e barabartë me vlerën kontabël neto të këtyre aktiveve në Bilanc.

Angazhimet e financimit shtesë, garancitë e emetura në favor të klientëve dhe angazhimet e tjera jashtë bilancit përbëjnë gjithashtu risk (shiko shënimin 19).

Përqëndrimi i riskut të kreditimit për zërat e bilancit apo jashtë tij ekziston edhe për palët e treta kur këta kanë karakteristika të ngjashme. Kjo do të shkaktonte reagimin në mënyrë të njëjtë ndaj dukurive ekonomike dhe paftësinë e njëkohëshme për të plotësuar detyrimet e tyre kontraktore. Risku i kreditimit ka përqëndrim më të madh në rastin e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve, angazhimeve për financim si dhe garancive të dhëna.

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e huave dhe paradhënieve dhënë klientëve sipas sektorëve të industrisë, pa përfshirë interesin e përllogaritur:

Sektorët e industries	31 Dhjetor			
	2005	%	2004 (pa audituar)	%
Tregëti me shumicë	13,967	63	11,902	71
Prodhim	2,368	11	1,484	9
Konsum	2,624	12	1,754	10
Shërbime	1,427	6	1,320	8
Hotele dhe restorante	566	3	158	1
Agrikulturë	14	-	79	-
Ndërtim	1,090	5	-	-
Të tjera	62	-	172	1
Totali	22,118	100	16,869	100

Huatë dhe paradhëniet e klientëve në fund të vitit 2005, janë siguruar nëpërmjet hipotekave, lënies peng të makinerive, pajisjeve, si dhe garancive personale si në vijim.

	31 Dhjetor 2005	%	31 Dhjetor 2004 (i pa audituar)	%
Hipoteka	15,130	68	10,426	61
Depozita në para	170	1	126	1
Pengje	6,232	28	5,334	31
Mikse (hipoteka dhe pengje)	586	3	1,101	7
Totali	22,118	100	16,987	100

(iv) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit lind si rrjedhojë e politikës së administrimit të fondeve dhe administrimit të pozicionit. Përfshin si riskun e paaftësisë për të investuar në aktive me maturime të përshtatshme dhe për të likuiduar një aktiv me çmim të arsyeshëm si dhe paaftësinë për të përmbushur detyrimet financiare në kohë.

Fondet krijohen nga përdorimi i një rangu të gjerë instrumentash duke përfshirë depozitat, detyrime të tjera të evidentueshme në kontrata si dhe kapitalin aksioner. Kjo rrit fleksibilitetin në sigurimin e fondeve. Banka përpiqet në maksimum për të ruajtur balancën midis fondeve të qëndrueshme dhe fleksibilitetit nëpërmjet financimeve me maturime të ndryshme. Banka bën vazhdimisht

vlerësim të riskut të likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar vazhdimisht nevojat për fonde në përputhje me strategjinë e përgjithshme të Bankës.

Gjithashtu Banka mban një vlerë të caktuar aktiveve likuide në portofol si pjesë e strategjisë së saj për administrimin e riskut.

Më 31 Dhjetor 2005 njëzet depozitat më të mëdha nga bizneset dhe individët përfaqësojnë 48.96% të totalit të depozitave nga klientët (2004: 46.72 %).

Tabela në vazhdim paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës grupuar sipas maturitetit të mbetur (bazuar në periudhat deri në ripagim).

PASQYRAT FINANCIARE

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

31 Dhjetor 2005						
	Deri në 1 Muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Assets	4,946	-	-	-	-	4,946
Arka dhe bankat	3,088	-	-	-	3,636	6,724
Llogarirë me Bankën Qendrore	8,621	-	-	2,500	-	11,121
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	2,677	310	316	5,727	12,141	21,171
Hua dhe paradhënie klientëve	59	-	-	-	-	59
Aktive të tjera	19,391	310	316	8,227	15,777	44,021
Totali						
Detyrimet	-	-	-	2,503	-	2,503
Detyrime ndaj institucioneve financiare	14,276	3,445	6,277	9,413	3,226	36,637
Detyrime ndaj klientëve	171	-	-	-	-	171
Detyrime të tjera	14,447	3,445	6,277	11,916	3,226	39,311
Totali	4,944	(3,135)	(5,961)	(3,689)	12,551	4,710
Pozicioni i likuiditetit më 31 Dhjetor 2004	4,944	1,809	(4,152)	(7,841)	4,710	-

31 Dhjetor 2004 (pa audituar)						
	Deri në 1 Muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
Assets						
Arka dhe bankat	4,894	-	-	-	-	4,894
Llogarirë me Bankën Qendrore	2,032	-	-	-	2,903	4,935
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	7,541	-	-	2,500	-	10,041
Hua dhe paradhënie klientëve	1,866	327	1,193	3,683	9,532	16,601
Aktive të tjera	97	-	-	-	-	97
Totali	16,430	327	1,193	6,183	12,435	36,568
Detyrimet						
Detyrime ndaj institucioneve financiare	-	-	-	2,503	-	2,503
Detyrime ndaj klientëve	10,130	2,118	16,796	-	-	29,044
Detyrime të tjera	120	-	-	-	-	120
Totali	10,250	2,118	16,796	2,503	-	31,667
Pozicioni i likuiditetit më 31 Dhjetor 2004	6,180	(1,791)	(15,603)	3,680	12,435	4,901
Pozicioni kumulativ më 31 Dhjetor 2004	6,180	4,389	(11,214)	(7,534)	4,901	-

23. Pasqyrimi në vlerë venale (fair)

Pasqyrimi në vlerë venale (fair) bazohet në instrumentat ekzistues financiare të bilancit pa u përpjekur të vleresojë në avancë vlerën e ardhme të biznesit dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk konsiderohen si instrumenta financiare.

Hua dhe paradhënie Institucioneve financiare

Huatë dhe paradhëniet dhënë institucioneve financiare përfshijnë vendosje bankë me bankë të

pamaturuara ende. Meqënëse depozitat njëditore janë depozita afatshkurtra dhe me norma të luhatshme vlera e tyre venale konsiderohet e barabartë me vlerën kontabile.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve paraqiten me vlerë bruto minus fondin rezervë për humbjet. Porofoli i kredisë së Bankës ka një vlerë venale të barabartë me vlerën kontabile për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe të normave të interesit të

Shenimet e pasqyrave financiare per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor 2005

(Shumat ne EUR '000, nese nuk shprehet ndryshe)

përafërta me normat e tregut.

Detyrim ndaj institucioneve financiare dhe klientëve

Vlera venale e depozitave pa afat, ku përfshihen depozitat që nuk fitojnë interes, është e barabartë me shumën e pagueshme me kërkesë të klientit. Vlera venale e depozitave me afat më 31 Dhjetor 2005 është EUR 27,240 mijë, ndërsa vlera e tyre kontabël është EUR 27,695 mijë. Vlera venale e depozitave me afat ne 31 Dhjetor 2005 është me e vogël se vlera e tyre kontabel per arsye te rritjes se norms se interesit te depositave ne 4.55% ne Dhjetor 2005. Vlera venale e depozitave ne 31

Dhjetor 2004 është e përafërt me vlerën e tyre kontabel ne kete date.

24. Transaksionet me palët e ndërlidhura

Gjatë vitit 2005 Banka është përfshirë në transaksione me kompanitë në pronësi të dhe të lidhura me Behgjet Pacolli, një nga aksionerët e Bankës.

Gjithashtu gjatë vitit 2005 Banka ka paguar në favor të Bordit të Drejtorëve të saj një shumë totale prej EUR 28 mijë (2004: EUR 25 mijë).

Të gjitha transaksionet e Bankës me palët e ndërlidhura janë kryer në kushte tregu.

Transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë (2004 i pa audituar):

Lloji i transakionit	Bordi i Drejtorëve		Aksionerët	
	Viti i mbyllur më 31 Dhejtor 2005	Viti i mbyllur më 31 Dhejtor 2004	Viti i mbyllur më 31 Dhejtor 2005	Viti i mbyllur më 31 Dhejtor 2004
<i>Në mijë EUR</i>				
Hua dhe paradhënie:				
Hua dhe paradhënie në fillim të vitit	5	2	520	255
Hua të akorduara gjatë vitit	44	4	1,605	520
Hua të ripaguara gjatë vitit	(14)	(1)	(1,275)	255
Hua dhe paradhënie në fund të vitit	35	5	850	520
Detyrime ndaj klientëve:				
Detyrime ndaj klientëve në fillim të vitit	91	-	21	1,100
Detyrime të lindura gjatë vitit	29	91	45,515	27,418
Detyrime të paguara gjatë vitit	(43)	-	(43,591)	(28,497)
Detyrime ndaj klientëve në fund të vitit	77	91	1,945	21
Blerje e mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	56	35
	31	31	31	31
	Dhejtor	Dhejtor	Dhejtor	Dhejtor
	2005	2004	2005	2004
Të ardhurat për vitin e mbyllur më				
Të ardhurat nga interesat	2	1	56	53
Tarifa dhe komisione	1	-	41	30
	31	31	31	31
	Dhejtor	Dhejtor	Dhejtor	Dhejtor
	2005	2004	2005	2004
Shpenzime për vitin e mbyllur më				
Shpenzime për interesat	1	-	58	18
Shpenzime të tjera	28	25	-	-

25. Ngjarjet pas mbylljes së bilancit

Nuk ka ngjarje mbas mbylljes së bilancit që mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje informacioni shtesë në pasqyrat financiare të vitit 2005.

BEXCARD

kartela më e vlefshme në portofolin tuaj!



Duke ju konsideruar Juve si pjesën më të vlefshme të Bankës Ekonomike, mundohemi që gjithmonë t'ju sjellim risi, që ngrisin kualitetin e shërbimeve dhe dëshmojnë seriozitetin tonë dhe kujdesin e vazhdueshëm ndaj jush.

BeXcard përbën një nga risitë tona që do t'ju lehtësojë qasjen në të hollat tuaja dhe do t'ju mundësojë tërheqje të hollash përgjatë 24 orëve, çdo ditë të javës.

Adresat ku janë të vendosur Bankomatët:

Prishtinë

rr. Migjeni nr.1
rr. Nëna Terezë 25b
Tel. 038 244 396

Mitrovicë,

Rr. Agim Hajrizi nr.26,
Tel.&Fax.: 028/34 700

Pejë

rr. "122" nr.2
Tel.&Fax.: 039/348 15

Gjakovë

rr. UÇK-së, p.n.
Tel.&Fax.: 0390/24 861

Prizren

sheshi "Skenderbeu" p.n.
Tel.&Fax.: 029/42 234

Ferizaj

rr. Bislim Rexhepi p.n.
Tel.&Fax.: 0290/21 260

Gjilan

rr. Adem Jashari p.n.
Tel.&Fax.: 0280/23 609

Ekspozitura në Burim (Istog)

rruga kryesore p.n.
Tel.&Fax.: 039/51 339

Ekspozitura në Rahovec

rr."Sylejman Vokshi" nr.2
Tel.:029/ 77 902

Dëshironi
që të ndërroni dicka
në jetën tuaj?

Banka Ekonomike
ju ofron zgjidhjen!

Për një kohë shumë të shkurtë pas aplikimit,
ne ju mundësojmë marrjen e kredive të
ndryshme për nevojat tuaja momentale,
me kamata shumë të volitshme dhe afat të
kthimit deri në 5 vite.



KREDI PËR RENOVIMIN E BANESAVE



KREDI PËR BLERJEN E VETURËS



KREDI PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT



KREDI PËR BLERJEN E MALLËRAVE



KREDI PËR NEVOJAT TUAJA PRIVATE

Kartela më prestigjioze në botë
vetëm tek ne!!!

AMERICAN EXPRESS

të cilën mund ta shfrytëzoni në
të gjitha vendet e botës.

*Aplikoni për kartelë American Express
dhe bëhuni pjesë e botës së privilegjuar!*

Llogaria e veçantë për fëmijë
"FATOSAT"

A dëshironi si prind të krijoni
te fëmijët tuaj
shprehi kursimi dhe më shumë siguri
në të ardhmen e tyre?

Investoni në FATOSAT
llogari e veçantë për fëmijët

